



MANUAL PËR NDJESHMËRI  
GJINORE NË RAPORTIM TË DHUNËS  
NË BAZË GJINORE NË MEDIA



*Trajnim për media rreth  
ndjeshmërisë gjinore*



# MANUAL PËR NDJESHMËRI GJINORE NË RAPORTIM TË DHUNËS NË BAZË GJINORE NË MEDIA

Trajnim për media rreth  
Ndjeshmërisë gjinore



Në shumë shoqëri, ndër paragjykimet mbizotëruese është pabarazia gjinore që reflekton në sferat socio-ekonomike dhe politike të jetës, dhe që kufizon rolet dhe përgjegjësitë e ndryshme që gratë mund t'i kenë. Kjo pabarazi përjetësohet dhe acarohet nga portretizimi i grave në mediet e shkruara dhe elektronike, si mjete të fuqishme me ndikim të gjerë, përfshirë psikikën njerëzore.

Paragjykimet gjinore të atyre në punojnë në media janë një nga pengesat kryesore të portretizimit të ndryshëm të grave dhe zërave të tyre në medie. Gazetarët dhe redaktorët shoqërohen si burra dhe gra, para se ta zgjedhin gazetarinë si karrierë. Ky shoqërim ndikon se si ata raportojnë, dhe se si i portretizojnë dhe u ofrojnë qasje grave.

Hulumtime të kryera nga grupet vëzhguese të medieve tregojnë që lajmet tregohen përmes syve, zërave dhe perspektivave të burrave. Medie shpesh gabojnë duke supozuar që kur flitet për gjini, flitet për gratë. Kjo rezulton me një qasje të lajmeve që fokusohen në gratë si anëtare të izoluara të shoqërisë me nevoja dhe interesa të veçanta. Përderisa kjo mund të jetë e vërtet për shkak të statusit të varur të grave në shoqëri përrreth globit, kjo qasje i marginalizon zërat e grave dhe i stereotipizon rolet e tyre.

Raportimet e mediave për të ashtuquajturat çështje të grave nuk ndërlidhen me çështje të shoqërisë në përgjithësi, dhe nuk arrijnë t'i bëjë të dukshme raportet e ndërlidhura ndërmjet roleve gjinore, qasjes në resurse dhe pushtetit. Mbulimi medieik i incidenteve të dhunës në bazë gjinore zakonisht karakterizohet me paragjykimet dhe gjuhë të papërshtatshme, si dhe me problemin e nën-raportimit.

Trajnimi gjinor për medie është i rëndësishme. Trajnimi u ndihmon gazetarëve dhe redaktorëve t'i kuptojnë qëndrimet, paragjykimet, të anuarit dhe socializimin që shpesh vjen përmes porosive në media, dhe i lejon ata ta njohin dhe ta analizojnë mungesën e balancimit të zërave të grave krahasuar me të burrave në media. Trajnimi gjinor ofron shkathtësi dhe teknika për gazetarët dhe redaktorët të analizojnë faktet, çështjet, dhe të dhënat nga perspektiva gjinore.

## SI TA PËRDORIM KËTË MANUAL

Programi trajnues mund të realizohet duke i përdorur pjesët e Manualit bashkë me materialet e tjera trajnuese, relevante me temat e mbuluara. Sugjerohet fuqishëm që trajnimi të përmbaj më shumë praktikë sesa teori, të përdor ushtrime dhe shembuj nga medie për të ndihmuar pjesëmarrësit të analizojnë dhe të fuqizojnë sensin praktik të përmbajtjes së ofruar në sesione.

Materiali i përfshirë në këtë Manual shërben vetëm si udhëzues, dhe trajnerët duhet të shtojnë informacion shtesë, ushtrime dhe shembuj të përshtatshëm për audiencën e synuar për trajnim. Trajnuesi apo trajnuesja duhet t'i përshtat ushtrimet për të siguruar që diskutimet dhe ushtrimet përfshihen krahas pikave kyçe të trajnimit.

1.

2.

3.

## KËSHILLA DHE TEKNIKA TRAJNUESE

Në fillim të secilës ditë, trajneri apo trajnerja duhet (të pyes njërin nga pjesëmarrësit të bëjë këtë) të përmbledh pikat nga sesioni i kaluar dhe të bëjë ndërlidhjen e tyre me sesionin e radhës. Me fjalë të tjera, trajneri/ja duhet të shpjegojë në konceptin e „ndërtimit të ndërlidhur“ të sesioneve, p.sh., secili sesion lidhet me tjetrin me qëllim që t'i ndihmojë pjesëmarrësit/et të fitojnë më shumë njohuri dhe kuptueshmëri për një çështje përmes kombinimit të përmbajtjes dhe ushtrimeve.

Është me rëndësi të caktohet një bashkë-trajner/e gjatë programit trajnues për të mbledhur shënime në bazë ditore rreth secilit diskutim, çështjeve dhe pyetjeve të parashtruara, observimeve të temave që nxisin më së shumti diskutim, observimet e të trajnuarve/ave dhe aspektet e sesioneve që kanë qenë më të kapshme dhe ato më të vështirat.

### AUDIENCA E SYNUAR

Audienca e këtij trajnimi janë gazetarët dhe gazetaret që punojnë në media të shkruara dhe elektronike. Aspektet e trajnimit që kanë të bëjnë me të intervistuarit/at, përdorimin e të dhënave dhe kontrollimit të fakteve dhe informacionit vlejnë për të gjitha llojet e mediave.

### PËRGATITJET

1. Trajneri/ja duhet të kërkojë nga pjesëmarrësit të sjellin katër deri në pesë artikuj dhe raporte për dhunën në bazë gjinore. Këta artikuj mund të përdoren në ushtrime gjatë trajnimit.

2. Trajneri/ja duhet të sigurohet që të gjithë/a pjesëmarrësit/et të sjellin kopje të një prej gazetave kryesore të përditshme në vend. Gazetat ditore mund të ofrojnë lajme aktuale për analizë dhe ushtrime.

3. Trajneri/ja duhet të njihet me të gjitha fletëpalosjet e ofruara në Manual. Fotokopjimi i tyre duhet bërë para programit. Trajneri/ja duhet të lexojë dhe të theksojë pikat kyçe të fletëpalosjeve, në momentin që ato t'iu ipen pjesëmarrësve/eve përgjatë sesioneve. Trajneri/ja nuk duhet thjeshtë t'i shpërndajë fletëpalosjet dhe të vazhdojë tutje. Është e rëndësishme që ato të përdoren gjatë procesit të mësimdhënies.

### KU TË FILLOJMË

Ditën e parë të trajnimit, para se trajneri/ja të vazhdojë me sesionet, duhet të realizohen këto veprime hyrëse:

- Prezantoni veten, organizatën që përfaqësoni dhe shpjegojuni pjesëmarrësve/eve arsyen se “Përse po mbahet ky trajnim?”
- Ftoni pjesëmarrësit/et që të prezantohen duke treguar emrat e tyre dhe organizatën e mediave për të cilën punojnë. Prezantimet mund të bëhen si “intervista” me ç’rast një pjesëmarrës

mund të lëvizë me mikrofoni si prezantues, ose pjesëmarrësit/et mund të intervistojnë njëri/a-tjetrin/ën. Trajnerët/et inkurajohen të jenë kreativë/e në strukturim të seksionit të prezantimeve.

- Ofroni secilit/ës pjesëmarrës/se nga një letër dhe laps. Kërkoni nga secili person që të shkruajë një pritshmëri që ai apo ajo ka për trajnimin. Mblidhni pritshmëritë dhe vendosni ato në mur apo tabelë. Lexojeni secilën pritshmëri me zë të lartë.

Në fund të prezantimit, trajneri/ja duhet t'i vendosë pikat nga axhenda e trajnimit para pjesëmarrësve/eve dhe t'i përshtasë ato me pritshmëritë e tyre. Vëreni pritshmëritë që mund të mos përmbushen gjatë trajnimit dhe sugjeroni mënyra se si pjesëmarrësit/et mund t'i përmbushin ato.

Përshtatja e përmbajtjes së Manualit me pritshmëritë e pjesëmarrësve/eve është mënyrë për të ndarë axhendën e trajnimit dhe njohuritë dhe të kuptuarit që të trajnuarit/at mund të presin të pranojnë nga trajnimi.

**SESSIONI**



# HYRJE DHE VËSHTRIM

## SESIONI 1

# NJOFTIM DHE VËSHTRIM



### OBJEKTIVAT:

Në fund të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

1. Shpjegojnë objektivat e punëtorisë.
2. Ndajnë pritshmëritë e tyre për punëtorinë.



### HAPAT:

- A. Hapja
- B. Prezantimet
- C. Pritshmëritë e pjesëmarrësve dhe Objektivat e Punëtorisë
- D. Shqyrtim i orarit të punëtorisë



### MATERIALET:

- Tabelë dhe Letër të Bardhë
- Shënjes
- Karta për shënime



### FLETËPALOSJET:

- Objektivat e Punëtorisë

### PËRGATITJE E VEÇANTË:

Ftoni një folës mysafirë apo një person tjetër të përshtatshëm për të bërë fjalimin hyrës.

Mysafiri folës potencial mund të jetë ndonjë person i mirënjohur nga sektori i mediave, shoqërisë civile, apo OJQ-ve. Ai apo ajo duhet t'i ketë po ato vlera të organizatës trajnuese për barazinë gjinore dhe përfqësimit të dhunës në bazë gjinore në media.



## A. HAPJA

### Hapi A1

Hyrje e shkurtër. Uroju pjesëmarrësve/eve mirëseardhje në punëtori dhe prezantoni trajnerët/et. Më pas, kërkoni nga pjesëmarrësit/et të prezantohen. Shpjegojuni pjesëmarrësve/eve që kjo do të jetë një punëtori e përbashkët dhe pjesëmarrja e tyre aktive do ta bëjë punëtorinë të suksesshme.

### Hapi A2

Punëtorja hapet me fjalimin hyrës të një mysafiri/je, drejtorit. es të projektit apo të një personi tjetër të përshtatshëm.

## B. PREZANTIMET

### Hapi B1

Shpjegojuni pjesëmarrësve/eve se ata/ato duhet të njohin njëri/a-tjetrin/ën duke qenë se kjo është një punëtori e përbashkët ku ata/ato do të mësojnë duke bashkëpunuar me njeri/a-tjetrin/ën. Ofroni secilit/ës pjesëmarrës/e nga një letër tabele dhe kërkoni nga ta/to të shkruajnë titujt e mëposhtëm dhe t'i plotësojnë të dhënat si në vijim:

- Emri:
- Organizata:
- Titulli i punës/pozita:
- Interesat / Hobitë:
- Aspekti i preferuar i punës:
- Aspekti më së paku i preferuar i punës:

### Hapi B2

Ftoni secilin/ën pjesëmarrës/e të ndajë shënimet me grupin.

## C. PRITSHMËRITË E PJESËMARRËSVE/EVE DHE OBJEKTIVAT E PUNËTORISË

### Hapi C1

Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të ndajnë pritshmëritë e tyre për punëtorinë. Ofroni secilit/ës pjesëmarrës/e dy fletë për shënime dhe një laps. Kërkoni nga ta/to të shkruajnë nga një pritshmëri në secilën fletë dhe ngjitni fletat në mur që t'i shohin të gjithë/a. Ftoni një pjesëmarrës/e t'i lexojë disa fleta dhe nëse është e mundur, shkruani pritshmëritë e ngjashme nën një titull kryesor. Përsëriteni këtë derisa të gjithë fletat të jenë lexuar dhe grupuar.

### Hapi C2

Shpërndani Fletëpalosjet – Objektivat e Punëtorisë. Krahasoni pritshmëritë e pjesëmarrësve/seve me këto objektiva. Nëse pritshmëritë nuk janë të adresuara në axhendën e punëtorisë, kërkoni mënyra se si ato mund të përfshihen. Mund të jetë e nevojshme të shtohet, fshihet apo të ndryshohet axhenda e punëtorisë me qëllim këto pritshmëri të përmbushen.

### Hapi C3

Nëse një pjesëmarrës/e ka një pritshmëri që nuk mund të përmbushet lehtë gjatë punëtorisë, diskutoni se si mund të përmbushet ajo, ndoshta gjatë një trajnimi në të ardhmen. Nëse ajo pritshmëri nuk është brenda sferës së aktiviteteve të planifikuara, diskutojeni këtë hapur.

## D. VËSHTRIM I ORARIT TË PUNËTORISË

### Hapi D1

Shpërndani orarin e punëtorisë. Lexoni atë bashkë me pjesëmarrësit/et, duke ofruar hapësirë për pyetje dhe sqarime. Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të zgjedhin një "përfaqësues/e të klasës" i/e cili/a do të shërbejë si urë lidhëse në mes pjesëmarrësve/eve dhe trajnerëve/eve, dhe të sigurohet që nevojat e pjesëmarrësve/eve të përmbushen.

## SESIONI 1 – FLETËPALOSJA – OBJEKTIVAT E PUNËTORISË

Objektivat e punëtorisë janë si në vijim:

- Të rrisë ndjeshmërinë për çështje gjinore përmes krijimit të një të kuptuari më të drejtë të koncepteve „seks“ dhe „gjini.“
- Të zhvillojë të kuptuarit e përkufizimit, mënyrave dhe metodave të dhunës në baza gjinore.
- Të diskutojë mangësitë e përgjithshme në raportimin e çështjeve të grave, veçanërisht ato të dhunës ndaj grave.
- Të përmirësojë shkathtësitë dhe cilësinë e të të raportuarit të dhunës në baza gjinore në media.



**SESIONI**

# KORNIZË PUNE PËR ANALIZË GJINORE PËR MEDIA

## SESIONI 2

# KORNIZË PUNE PËR ANALIZË GJINORE NË MEDIA



### OBJEKTIVAT:

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit/et do të jenë në gjendje të:

1. Kuptojnë se si medie i paraqesin gratë.
2. Diskutojnë perceptimet e gazetarëve/eve për rolin e tyre.
3. Identifikojnë elementet që ndikojnë në pavarësinë e mediave..



### HAPAT:

- A. Paraqitja e Grave në Media
- B. Roli i mediave në shoqëri
- C. Pavarësia e Medieve



### MATERIALET:

- Tabelë dhe Letër
- Laps
- Letër për shënime



### FLETËPALOSJET:

- 1: Mediat e Pavarura
- 2: Pavarësia Editoriale

## A. PËRSHKRIMI I GRAVE NË MEDIA

### Hapi A1

Ndani pjesëmarrësit/et në dy grupe. Shkruani thënien në vijim në një tabelë:

*„Në një botë që shihet përmes lenteve të medieve, rolet shoqërore dhe profesionale janë pothuajse plotësisht të ndara në linja gjinore. Kur gratë paraqiten – dhe shumë studime përreth botës dokumentojnë nën-përfaqësimin dramatik të tyre pothuajse në të gjitha llojet e përmbajtjes mediatike – ato kanë tendencë të prezantohen brenda shtëpisë, dhe rrallë portretizohen si racionale, aktive apo të vendosura.”*

Kërkoni nga njëri grup të citojë nga mediet në vendet e tyre (nga shtypi, portalet online, apo transmetuese) që e mbështet pohimin më lart. Grupi i dytë duhet t'i theksojë shembujt nga medie në vendet e tyre që e dëshmojnë të kundërtën – gratë në role të ndryshme shoqërore dhe profesionale.

Ofroni secilit grup nga 10 minuta kohë për të raportuar. Trajneri apo trajnerja duhet t'i shkruajë shembujt e cituar. Diskutoni për imazhet se si përshkruhen gratë në media nga shembujt e marrë.

Shfrytëzoni pikat që dalin nga diskutimi për të vazhduar me pjesën në vijim për rolin e mediave në shoqëri.

## B. PËRCEPTIMI I GAZETARËVE/EVE PËR ROLIN E TYRE

### Hapi B1

1. Ofroni secilit/ës gazetar/e një letër dhe laps.
2. Kërkoni nga ata/atotë shkruajnë dy shembuj të asaj që ata/ato konsiderojnë si rolin e tyre si gazetarë/e në shoqëri.
3. Vendosni letrat në mur apo në tabelë dhe lexoni përgjigjet e ndryshme me grupin. Kur vëreni ngjashmëri, shënjoni ato për të parë nëse grupi ka përciptim të njëjtë për rolin e tyre.

### Hapi B2

Shkruani pikat e mëposhtme në tabelë ose fletë table dhe shpjegoni që pikat në vijim janë besime më të zakonshme për rolin e gazetarëve/eve në kontekstin e rolit të mediave në shoqëri:

- Shërbimi më e mirë që media mund t'i ofrojë publikut, qoftë në një demokraci të zhvillim apo në zhvillim e sipër, është ajo e kujdestarit/es të komunitetit. Funkcioni i tij/saj duhet të zbatohet në të gjithë sektorët e shoqërisë.
- Të jesh gazetar/e nuk është thjesht punë. Nuk është as thjesht një profesion. Gazetarët/et duhet të shohin dhe performojnë rolet e tyre si shërbim ndaj interesit publik.
- Përderisa ata/ato performojnë rolin e kujdestarit/es dhe kur ata/ato gjurmojnë për të vërtetën, gazetarët/et duhet të jenë të kujdesshëm/me nga prezantimi i një të vërtete si e vërtetë absolute.

## SESIONI 2 – FLETËPALOSJA 1 – MEDIA E PAVARUR

*„Një gazetë (medium) e pavarur është ndërmjetësuese e sinqertë e informacionit për lexuesit pa njëanshmëri apo favorizim të qëllimshëm. Një gazetë e pavarur (medium) konsideron se pavarësia e saj është aset më i vlefshëm komercial, editorial dhe moral. Ajo e ruan pavarësinë e saj në mënyrë që të mund t'i flas të gjithë anëtarëve të audiencës gjatë gjithë kohës. Ajo mirëmban pavarësinë përmes sjelljes profesionale, dhe principet i bën të njohura për të gjithë të punësuarit (politikë konkrete) dhe për të gjithë lexuesit apo klientët komercial që duan ta njohin. Një gazetë e pavarur (medium) nuk i bazon vendimet profesionale në interesa të ngushta ekonomike apo politike për asnjë grup, përfshirë vetveten.”*

Pasi t'i keni diskutuar pikat e mësipërme me pjesëmarrësit/et, krahasoni ato me perceptimet e gazetarëve/eve për rolet e tyre. Theksoni shembujt ku përgjigjet e pjesëmarrësve/seve përputhen me pikat e lartpërmendura.

### Hapi B3

Shënjoni fjalën “publik” në Hapin B2 – dhe pyesni gazetarët/et: “Kush është publiku? Cilat janë grupet e ndryshme të shoqërisë që përbëjnë publikun?” – Shkruani përkufizimet e tyre të publikut e medias dhe tregoni që, më vonë në trajnim, grupi do t'u kthehet këtyre pyetjeve për të analizuar se sa mirë reflektojnë mediet, apo nuk e reflektojnë “publikun” në mbulimin e tyre mediatik.

Jepni secilit/ës pjesëmarrës/e një kopje të Fletëpalosjes 1 – Media e Pavarur. Kërkoni nga dikush nga grupi të

lexojë Fletëpalosjen, dhe kërkoni mendimin e grupit për përshkrimin e medias së pavarur të paraqitur në Fletëpalosjen I. (Maksimumi 10 minuta).

Pas diskutimit, shënjoni fjalët e nënvizuara në tekst – “lexuesit/et”, “anshmëri apo favorizim”, “për të gjithë/a anëtarët/et e audiencës së saj”. Prapë, kërkoni nga pjesëmarrësit/et të reflektojnë në fjalët sikurse “lexuesit/et”, “të gjithë/a anëtarët/et e audiencës së saj”, dhe të vlerësojnë nëse përmbajtja mediatike i përfshinë apo përjashtoi disa grupe – burrat, gratë, fëmijët, të moshuarit, etj., në shoqëri.

### Hapi B4

Shkruani pesë pikat e mëposhtme në tabelë, dhe pastaj përdorni këto pika që të përqendroni diskutimin në pikën e pestë, e cila është themelore për gjininë në media.

## SESIONI 2 – FLETËPALOSJA 2 – PAVARËSIA EDITORIALE

Pavarësia editoriale është thelbi i shtypit të lirë, gjë kjo e cila nënkupton pavarësi nga forcat brenda dhe jashtë mediumit, veçanërisht nga:

1. Qeveria.
2. Partitë dhe interesat politike.
3. Interesat biznesore dhe komerciale, përfshirë ato të reklamuesve/eve.
4. Miqtë/miket e gazetarëve/eve.
5. Paragjykimet e vet gazetarëve/eve, besëtytnitë dhe anshmëritë.

## PIKAT KRYESORE PËR DISKUTIM

Përgjatë shqyrtimit të këtyre pesë pikave, ka ende kufizime që mediet duhet t'i tejkalojnë me qëllim që të arrijnë fazën e pavarësisë editoriale. Ka shumë njerëz që mbrojnë idenë se nuk do të ketë asnjëherë media plotësisht të pavarur nga të gjitha forcat.

Megjithatë, pika e fundit sjellë një dimension të ri konceptit të pavarësisë editoriale, duke qenë se ajo qëndron përbrenda fuqive të pushtetit të gazetarit/es dhe redaktorit/es për ta ndryshuar. Kjo pikë është kritike ndaj secilit diskutim për gjininë në media sepse vë në pah forcën e fshehur të socializimit në perceptimin e gazetarëve/eve dhe redaktorëve/eve për atë se ku burrat dhe gratë „duhet“ të qëndrojnë në shoqëri. Pavetëdjshëm, këto anshmëri rrëshqasin në praktikën mediatike. Këto dërgojnë në portretizime negative dhe stereotipike të burrave dhe grave dhe praktikave gazetareske të mbledhjes së informacionit të cilat shpeshherë përjashtojnë gratë si burime, duke e kufizuar zërin e tyre në/dhe përmes medias.

Hulumtimi qartë tregon që raporti ndërmjet masmediave dhe grave i tejkalon kufijtë e klasës, kufijtë kulturor, kombëtar dhe rajonal. Mënyra se si gratë portretizohen në media në Afrikë ka më shumë ngjashmëri sesa dallime me mënyrën se si gratë portretizohen në media në Azi, Evropë, Amerikë Latine dhe Amerikë Veriore. Sa i përket relacioneve gjinore, media në botë vepron si forcë kulturore që në mënyrë të heshtur dhe jo të drejtpërdrejtë ndihmon në formësimin në vend se thjesht në reflektimin e realitetit shoqëror të burrave dhe grave.

Anshmëritë dhe paragjykimet e përvetësuara nga gazetarët/et dhe redaktorët/et përmes socializimit të tyre brenda shoqërive ku ata/ato tani shkruajnë, ka ndikim më të madh në produkte mediatike sesa që ata/ato e kuptojnë. Përmes trajnimit gjinor, gazetarët/et dhe redaktorët/et mund të vetëdijesohen më shumë se si paragjykimet e tyre të përditësuara dhe anshmëritë e tyre të brendshme ndikojnë në mbulimin e tyre po aq sa forcat e jashtme sikurse censura qeveritare.

Një preokupim i hulumtimit të komunikimit masiv supozon se porositë dhe imazhet që na vijnë nga mediet përbëjnë forcë të fuqishme shoqërore, kulturore dhe politike, dhe që ekziston një lidhje ndërmjet një produkti mediatik dhe vetëdijes shoqërore.

Masmedia është forma kryesore e komunikimit e përdorur për të arritur tek një numër i madh i njerëzve në cilëndo kohë. Media është e pajisur mirë për të ndikuar në opinionet, besimet, qëndrimet dhe standardet, si dhe për nocionin e vetvetes, që ideja se kush jemi si meshkuj dhe femra të ndikohet nga porosi me vlerë.

1.

2.

3.

4.

5.

6.

**SESIONI  
INOISES**





# TË KUPTUARIT E GJINISË

## SESIONI 3

# TË KUPTUARIT E GJINISË



### OBJEKTIVAT:

Në fund të këtij sesiioni, pjesëmarrësit/et do të jenë në gjendje të:

1. Identifikojnë kujtimet e hershme se kur dhe si kanë mësuar se çka do të thotë të jesh mashkull apo femër.
2. Identifikojnë pritshmëritë e roleve gjinore dhe stereotipet gjinore.
3. Përkufizojnë gjininë.
4. Përkruajnë se si institucionet dhe sistemet në kulturën e tyre i krijojnë dhe mirëmbajnë stereotipet gjinore.



### HAPAT:

- A. Kujtime të Hershme se çka do të thotë të jesh Mashkull apo Femër
- B. Pritshmëritë për Rolet Gjinore dhe Stereotipet
- C. Përkufizimi i Gjinisë
- D. Ndikimi Institucional/Sistemor në Sterotipet Gjinore



### MATERIALET:

- Tabelë dhe Letër
- Laps



### FLETËPALOSJET:

- Seksi dhe gjinia

### PËRGATITJE E VEÇANTË:

Vizatoni një tabelë me mbishkrimin “Seksi dhe Gjinia” në fletë gazete.

TABELA: – Seksi dhe Gjinia –

- E konstruktuar biologjiksht / nga shoqëria
- Lindemi me / Nuk lindemi me
- Nuk mund të ndryshohet / Mund të ndryshohet

## A. KUJTIME TË HERSHME SE ÇKA DO TË THOTË TË JESH MASHKULL APO FEMËR

### Hapi A1

Si hyrje në këtë sesion, kërkoni nga pjesëmarrësit/et të demonstrojnë një qëndrim apo pozicion që përshkruan se si perceptohen gratë dhe burrat në shoqëri. Për grupe të përziera, kërkoni nga burrat të përshtatin pozicione që përshkruajnë burrat, dhe nga gratë të përshtatin pozicione që përshkruajnë gratë; në një grup të të njëjtit seks, kërkoni nga të gjithë/a pjesëmarrësit/et të përshkruajnë pozicione meshkujsh, dhe pastaj kërkoni nga të gjithë/a pjesëmarrësit/et të përshkruajnë pozicione femrash.

### Hapi A2

Kërkoni nga secili/a pjesëmarrës/e të përshkruajë se çka tregon qëndrimi apo pozicioni i tij/saj. Kërkoni nga ta/to të konsiderojnë se çka reflektojnë qëndrimet apo pozicionet për mënyrën se si shoqëria i percepton burrat dhe gratë.

### Hapi A3

Prezantoni pjesën kryesore të sesionit duke e shpjeguar atë përmes punëtorisë gjinore. Por veçanërisht në këtë sesion, nga pjesëmarrësit/et do të kërkohet të ndajnë kujtime dhe përvoja personale rreth gjinisë, dhe që këto kujtime dhe përvoja ndonjëherë mund të jenë të vështira për t'u diskutuar.

Theksoni që sukcesi i sesionit dhe punëtorja varen nga vullneti i pjesëmarrësve/eve që të ndajnë, por që nga askush nuk do të kërkohet që të flasin nëse ata/ato nuk duan.

### Hapi A4

Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të ndahen në përafërsisht katër (4) grupe të vogla të të njëjtit seks. Shpjegoni që ata/ato duhet të krijojnë grupe sipas zgjedhjes së tyre për të siguruar që ata/ato janë me pjesëmarrësit/et me të cilët/at ndihen rehat t'i ndajnë përvojat personale.

(Shënim: Nëse ndodh që të ketë vetëm një burrë apo vetëm një grua në grup, pjesëmarrësit/et mund të formojnë vetëm dy (2) grupe, një me pjesëmarrës/e të të njëjtit seks, dhe një grup i përzier.)

### Hapi A5

Prezantoni Detyrën #A5:

#### DETYRA A5

1. Në mënyrë individuale, rikujtoni përvojën më të hershme, më të rëndësishme dhe më kuptimplotë që lidhet me të kuptuarit se çka do të thotë të jesh mashkull apo femër, dhe si rrjedhojë ndryshe nga seksi tjetër.

2. Pas disa minutave të reflektimit individual, ndani këtë përvojë me anëtarët e tjerë të grupit tënd.
3. Si grup, krijoni një dramë, fotografi, poemë, këngë, tregim, apo vallëzim që reflekton kujtimet e ndara brenda grupit.

### Hapi A6

Kërkoni nga secili grup të prezantojë dramën, fotografinë, poemën, këngën, tregimin, apo vallëzimin. Bëni pyetje për kujtimet e individëve të ndarë brenda grupeve që do të inkurajojnë diskutim:

- Si jeni ndjerë gjatë përvojës?
- Çka ju ka treguar përvoja se çka do të thotë të jesh femër? Të jesh mashkull? Për jetën?
- Cilat kanë qenë pritshmëritë e familjes suaj për ju? Pritshmëritë e familjes?
- Çfarë pritshmëri dhe aspirata keni pasur për vetveten?
- Çfarë përfundimesh dhe mësimesh keni nxjerrë nga përvoja?

## B. PRITSHMËRITË PËR ROLET GJINORE DHE STEREOTIPET

### Hapi B1

Ndani pjesëmarrësit/et në grupe të vogla të të njëjtit seks. Dorëzoni secilit grup dy fletë gazete me titujt si në vijim:

Për gratë:

1. „(Në kulturën time), unë duhet të ... sepse jam grua.”
2. „Po të isha burrë, do të mund të...”

Për burrat:

1. „(Në kulturën time) unë duhet të ... sepse jam burrë.”
2. „Po të isha grua, do të mund të...”

### HAPI B2

Caktoni detyrën në vijim:

#### DETYRA B2

1. Mendoni përgjigjet për të thënat.
2. Shkruani ato ndër titujt kryesor.
3. Përgatituni të raportoni për një grup më të madh.

### Hapi B3

Kërkoni nga secili grup të ndajnë listën e tyre. Udhëzoni një diskutim rreth implikimeve që individët kanë për rolet dhe përgjegjësitë që u caktohen burrave dhe grave. Ja disa pyetje për të nxitur diskutimin:

- A duhet që gratë e burrat të jenë, apo t'i bëjnë, gjërat të cilat i keni shkruar?
- A mund t'i bëjnë gratë dhe burrat gjërat që priten nga seksi tjetër?

- Si ndikojnë këto role dhe përgjegjësi në vendimet jetësore?

Mos harroni të theksoni se edhe burrat e edhe gratë janë të kufizuar/a në sjelljet e tyre, për përgjegjësitë, dhe vendimet jetësore për shkak se kultura na i cakton rolet dhe përgjegjësitë.

#### Hapi B4

Shkruani frazën, “Qenia njerëzore brenda meje dëshiron ...” në një tabelë, dhe kërkoni nga pjesëmarrësit/et të shkruajnë përgjigjet për të përfunduar frazën.

#### Hapi B5

Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të përmbledhin çka kanë mësuar nga aktiviteti.

### C. TA PËRKUFIZOJMË GJININË

#### Hapi C1

Pyetni pjesëmarrësit/et, „Bazuar në të gjitha që keni mësuar deri më tani, si do ta përkufizonit gjininë?”

#### Hapi C2

Shkruani këto përkufizime në një tabelë. Kombinoni dhe përpunoni përkufizimet për të krijuar një përkufizim operacional.

#### Hapi C3

Postoni tabelën “Seksi” dhe “Gjinia” të cilën e keni vizatuar.

#### Hapi C4

Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të japin shembuj që do t’i takonin njërit nga këta dy tituj.

#### Hapi C5

Shpërndani Fletëpalosjen – Seksi dhe Gjinia. Kërkoni nga pjesëmarrësit/et ta lexojnë atë me zë të lartë. Sigurohuni që të gjithë/a e kuptojnë përkufizimin e gjinisë.

### D. NDIKIMI INSTITUCIONAL/SISTEMOR NË STEREOTIPET GJINORE

#### Hapi D1

Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të përpilojnë një listë të institucioneve dhe sistemeve që krijojnë dhe mirëmbajnë stereotipet gjinore.

Përgjigjet mund të jenë: familja, universitetet, media, feja, qeveria, ligjet, sistemi arsimor.

#### Hapi D2

Ndani pjesëmarrësit/et në katër grupe të vogla. Secilit grup t’i caktohet njëri nga grupet e listuara në Hapin D1. Kërkoni nga secili grup të diskutojë:

- Si krijohen dhe mirëmbahen stereotipet gjinore nga institucioni/sistemi? Jepni shembuj të sjelljeve stereotipike, praktikave, dhe politikave të institucionit.
- A keni vërejtur ndonjë ndryshim në institucionin apo sistemin që reflekton progres drejt një shoqërie me norma të drejta gjinore?

#### Hapi D3

Lejoni secilin grup t’i prezantojë të gjeturat.

#### Hapi D4

Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të përmbledhin çka kanë mësuar në këtë sesion.

## SESIONI 3 – FLETËPALOSJA – SEKSI DHE GJINIA

Konceptet “seksi” dhe “gjinia” mund të përkufizohen si në vijim:

**SEKSI:** I referohet dallimeve biologjike ndërmjet grave dhe burrave. Dallimet janë në përgjithësi të përhershme dhe universale.

**GJINIA:** I referohet roleve dhe përgjegjësi të formësuarar në mënyrë shoqërore për gratë dhe burrat në një kulturë apo lokacion.

Këto role ndikohen nga perceptimet dhe pritshmëritë që vijnë nga faktorët kulturorë, politikë, ambientale, ekonomike, shoqërorë, fetarë, si dhe nga zakonet, ligjet, klasa, etnia, dhe anësitë individuale apo institucionale. Qëndrimet rreth gjinisë dhe sjelljeve mësohen dhe mund të ndryshohen.

*Cilat janë disa nga situatat ku i shohim dallimet gjinore?*

**SHOQËRORE:** Perceptime të ndryshme për rolet shoqërore të grave dhe burrave: burri, si kryefamiljar dhe ai i cili i sjellë paratë në familje; gruaja, ajo që ushqen dhe përkujdeset për të tjerët/at.

**POLITIKE:** Dallimet në mënyrat se si gratë dhe burrat e supozojnë dhe e ndajnë pushtetin dhe autoritetin: burrat janë më të përfshirë në nivelin kombëtar dhe të lartë politik; gratë më të përfshira në nivel lokal në aktivitete që ndërlidhen me rolet e tyre shtëpiake.

**ARSIMORE:** Dallimet në mundësi dhe pritshmëritë arsimore për vajzat dhe djemtë: burimet familjare të drejtuara tek arsimimi i djemve sesa i vajzave; vajzat e drejtuara kah linja akademike më pak sfiduese.

**EKONOMIKE:** Dallimet në qasje për gratë dhe burrat në karriera fitimprurëse dhe kontroll rreth financave dhe burime të tjera produktive: kredi dhe hua; pronësi toke.

**SESIONI**

**4**

# PERCEPTIMET DHE PRITSHMËRITË GJINORE

## SESIONI 4

# PERCEPTIMET DHE PRITSHMËRITË GJINORE



### OBJEKTIVAT:

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit/et do të jenë në gjendje të:

1. Identifikojnë besimet dhe perceptimet e tyre për gratë dhe burrat.
2. Ekzaminonë se si mitet, tregimet, proverbat, thëniet, dhe institucionet e tjera shoqërore i krijojnë, mirëmbajnë, dhe përforcojnë stereotipet gjinore.
3. Identifikojnë mënyrat se si perceptimet dhe supozimet e attributeve femërore dhe mashkullore mund t'i kufizojnë përvojat dhe opsionet për gratë dhe burrat.
4. Identifikojnë strategjitë për t'i sfiduar dhe ndryshuar stereotipet e roleve gjinore.



### HAPAT:

- A. Perceptimet për Gratë dhe Burrat
- B. Bazat Kulturore për Stereotipizimin Gjinor
- C. Strategjitë për të Sfiduar dhe Eliminuar Sterotipet dhe Pengesat Gjinore
- D. Ushtrime për të Siguruar Përkufizimet e Stereotipeve të Seksit dhe Gjinisë



### MATERIALET:

- Një top i madh



### FLETËPALOSJET:

- Stereotipet e zakonshme gjinore



## A. PERCEPTIMET PËR GRATË DHE BURRAT

### Hapi A1

Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të qëndrojnë në një rreth me një person në qendër duke e mbajtur një top. Lojtari/ja në qendër fillon lojën duke thënë “Gratë janë...”, dhe në të njëjtën kohë e gjuan topin tek dikush tjetër.

### Hapi A2

Personi që e kap topin menjëherë e thotë një fjalë që i përkufizon gratë.

Ajo/ai duhet të përgjigjet në mënyrë spontane, pa u ndalur për të menduar, e gjuan topin përsëri në qendër dhe pastaj largohet nga rrethi.

### Hapi A3

Thirrësi/ja në qendër thotë “Burrat janë...”, dhe lojtari/ja që e kap topin përgjigjet në mënyrë spontane.

Udhëheqësi apo udhëheqësja vazhdojnë të thërrasin “Gratë janë...”, “Burrat janë...” kurdo që topi hidhet.

### Hapi A4

Përderisa lojtarët përgjigjen, një vullnetar i shkruan ato në një flipqart në dy kolumne me titujt “Gratë janë...” dhe “Burrat janë...”.

### Hapi A5

Postoni tabelën e përfunduar. Shpërndani Fletëpalosjen – Stereotipet e Zakonshme Gjinore. Kërkoni nga pjesëmarrësit/et që për disa minuta të krahasojnë listën me përgjigjet që i dhanë gjatë lojës.

Theksoni që fjalët në Fletëpalosje dhe në tabelë janë pjesë shumë e fuqishme e asaj se si e perceptojmë vetveten sa që tentojmë të mos mendojmë për to apo për fuqinë që ato e kanë në formësimin e qëndrimeve dhe mendimeve tona rreth asaj se çka është femër dhe çka është mashkull.

### Hapi A6

Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të bëjnë pyetjet si në vijim:

- A i përshkruajnë këto fjalë dhe shprehje rolet dhe përgjegjësitë që të gjithë i konsiderojnë “normale” apo “natyrale”?
- A i përshkruajnë ato atë që shoqëria ka vendosur personat femër dhe mashkull duhet të jenë apo të mos jenë?
- A sillen gratë dhe burrat sikurse që këto stereotipe të jenë të vërteta?
- Cilat janë disa nga pasojat e këtyre stereotipeve për gratë dhe burrat?

Përgjigje të mundshme: Ato i limitojnë gratë si grup. Krijojnë pritshmëri joreale dhe artificiale për të dy sekset. Ato i kufizojnë opsionet dhe zgjedhjet jetësore.

## B. BAZA KULTURORE E STEREOTIPEVE GJINORE

### Hapi B1

Ndani pjesëmarrësit/et në katër grupe dhe u caktoni detyrën në vijim:

#### DETYRA B1

1. Identifikoni mitet, fjalët e urta, tregimet, thëniet, këngët, etj, që i atribuojnë sjellje, karakteristika, dhe role për gratë dhe burrat.
2. Diskutoni stereotipet që përjetësohen nga këto shprehje kulturore.
3. Diskutoni se si këto stereotipe veprojnë si barriera për burrat dhe gratë në kufizimin e zgjedhjeve dhe opsioneve jetësore.

### Hapi B2

Lejoni secilin grup të raportojë lidhur me diskutimin e tyre. Lehtësoni diskutimin në grupe të mëdha duke i bërë pyetjet në vijim: përveç miteve, tregimeve, fjalëve të urta, besimeve kulturore dhe fetare, dhe thënieve popullore, çfarë lloj forcash apo agjendë të tjerë në shoqëri krijojnë ide dhe ndikojnë në qëndrimet për gratë dhe burrat?

Përgjigje të mundshme: mediet, reklamat, filmat, televizioni, gazetatat dhe revistat, shakatë, filmat e vizatuar, këngët e njohura, librat.

- Cilat janë disa nga porosítë e këtyre miteve, tregimeve, etj., për gratë dhe burrat?
- Si ndikojnë ato në ndjenjat e juaja për vetveten tuaj?
- Si ndikojnë ato në ndjenjat e juaja për gratë dhe burrat?
- Cilat janë disa nga rezultatet e këtyre barrierave shoqërore dhe kulturore të shkaktuara nga stereotipet?
- A i përjetojnë gratë dhe burrat këto barriera në mënyrë të barabartë apo në mënyra të ndryshme? Si ndikojnë këto barriera në raportet e tyre?

## C. STRATEGJITË PËR TË SFIDUAR DHE ELEMINUAR STEREOTIPET DHE PENGESAT GJINORE

### Hapi C1

Ndani pjesëmarrësit/et në tre (3) grupe për të diskutuar pyetjet në vijim:

- Çfarë lloj supozimesh dhe vlerash që ndërlidhen me të qenit femër apo mashkull në shoqërinë tuaj ju bëjnë më së shumti krenar/e apo të respektuar? Pse?
- Çfarë lloj supozimesh dhe vlerash që ndërlidhen me të qenit femër apo mashkull në shoqërinë tuaj nuk i pëlqeni dhe iu bëjnë të mos ndiheni i/e respektuar? Pse?
- Cilat nga këto do të donit më së shumti t'i ndryshonit? Pse?
- Diskutoni një mënyrë përmes së cilës tanimë e keni sfiduar apo ndryshuar një supozim apo vlerë që ndërlidhet me të qenit mashkull apo femër.

### Hapi C2

Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të mendojnë për stereotipe të tjera të cilat do të donin t'i sfidonin apo ndryshonin. Listoni ato në një tabelë.

### Hapi C3

Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të identifikojnë strategji për t'i përmbysur normat dhe vlerat kulturore që ndërlidhen me maskulinitet dhe femininitet dhe si kjo mund të ndikojë në jetën e tyre personale, në shtëpi dhe në punë.

### Hapi C4

Kërkoni nga pjesëmarrësit/et që të diskutojnë se çka kanë mësuar dhe bëni përmbledhjen.

Theksoni që të sfidohen stereotipet që vazhdimisht përforcohen kërkon shumë mund e përpjekje. Do të jetë edhe më e vështirë të ndryshohen besimet personale që janë përvetësuar përgjatë jetës së një personi.

## SESIONI 4 – FLETËPALOSJA – STEREOTIPET E ZAKONSHME GJINORE

Lista e Stereotipeve të Zakonshme për Femrat dhe Meshkujt

Gratë janë:  
Të varura  
Të dobëta  
Të paafta  
Më pak të rëndësishme  
Emocionale  
Zbatuese  
Amvise  
Përkrahëse  
Fragjile  
Labile  
Frikacake  
Paqësore  
Të kujdesshme  
Fleksibile  
Të ngrohta  
Pasive  
Përcjellëse  
Spektatore  
Modeste  
Subjektive  
Flasin butësisht  
Sekretare  
Ushqyese  
Të buta  
Ngacmohen lehtë  
Të durueshme  
Gazmore  
Përkujdesëse  
Bashkëpunuese

Burrat janë:  
Të pavarur  
Të pushtetshëm  
Të aftë  
Më të rëndësishëm  
Logjik  
Vendimmarrës  
Kryefamiljar  
Udhëheqës  
Mbrojtës  
Konsistent  
Të guximshëm  
Agresivë  
Aventurier  
Të fokusuar  
Bazohen në vetveten  
Aktive  
Udhëheqës  
Veprues  
Ambiciozë  
Objektivë  
Flasin lirshëm  
Bosa  
Të vendosur  
Të fortë  
Stoikë  
Të vrullshëm  
Energjikë  
Realizues  
Garues

## D. USHTRONI PËR TË KONSTATUAR SE PËRKUFIZIMET 'SEKS', 'GJINI', DHE 'STEREOTIPE GJINORE' KUPTOHEN

### Hapi D1

Lexoni për grupin fjalitë në vijim. Kërkoni nga pjesëmarrësit /et të ngriten në këmbë nëse fjalja i referohet gjinisë dhe të ulen nëse fjalja i referohet seksit. Kur të ketë mospajtime rreth fjalive, kërkoni nga ta/to t'i arsyetojnë opinionet e tyre.

### Seksi apo Gjinia?

- Gratë i lindin fëmijët, burrat jo.
- Vajzat e vogla janë të buta dhe të turpshme; djemtë janë të fortë dhe aventurierë.
- Në shumë vende, gratë fitojnë 70% të asaj që fitojnë burrat.
- Gratë mund t'i ushqejnë me gji foshnjat e tyre; burrat përdorin shishen për t'i ushqyer foshnjat.
- Gratë e kanë përgjegjësi t'i rrisin fëmijët.
- Burrat janë vendimmarrës.
- Në Egjiptin e vjetër, burrat kanë qëndruar në shtëpi dhe kanë thurur. Gratë merreshin me bizneset familjare. Gratë kanë trashëguar ndërsa burrat jo.
- Zërat e djemve pësojnë ndryshime në pubertet, ndërkaq të vajzave jo.
- Gratë e kanë të ndaluar të bëjnë punë të rrezikshme, sikurse në minierë nëntokësore; burrat marrin vetë këtë rrezik.

### Hapi D2

Është me rëndësi të kuptojnë se si formohet stereotipet gjinore. Këto stereotipe shpesh hasen në media sepse gazetarët (burra dhe gra) dhe redaktorët (burra dhe gra) janë produkte të shoqërisë ku janë rritur.

Shkruani përkufizimin e mëposhtëm në një tabelë. Pasi ta shpjegoni përkufizimin, kaloni 10 minuta duke i diskutuar stereotipet e zakonshme për burrat dhe gratë.

*Stereotipet = E reduktojnë një person në një shembull të thjeshtë të një karakteristike.*  
(Oxford English Dictionary)

*Stereotipet gjinore janë besime të ndërtuara nga shoqëria për gratë dhe burrat. Ato formohen përmes thënieve, këngëve, fjalëve të urta, medieeve, fesë, kulturës, traditave, arsimimit, dramës, etj.*

### Hapi D3

Ndani pjesëmarrësit /et në 3-4 grupe. Ofrojini secilit grup nga 20 minuta.

Së pari, grupet do t'i kenë 10 minuta për të menduar dhe të shkruajnë shembuj se si stereotipet gjinore përçohen në shoqëritë e tyre përmes:

- A. Fjalët e urta dhe thëniet
- B. Këngët
- C. Dramat
- D. Tradita, kultura
- E. Edukimi

Pastaj, i ofroni secilit grup 10 minuta për të raportuar. Trajnuesi apo trajnuesja duhet t'i shkruajë informacionet në një tabelë të siguruar në dhomën trajnuese.

Trajnuesi/ja duhet t'i shqyrtojë 2 kolumnet e fundit dhe të lehtësojë diskutimin me pjesëmarrësit/et për çështjet në vijim:

1. Cilat janë imazhet dominuese për burrat dhe gratë që na transmetohen çdo ditë përmes gjuhës, pop kulturës, medieeve të përgjithshme, etj?
2. Çfarë lloj ndikimi kanë?
3. Si mund të ndryshohen këto stereotipe?

**SESIONI**

**5**

PËRKUFIZIMI I  
DHUNËS NË BAZË  
GJINORE DHE  
DHUNËS  
NDAJ GRAVE

## SESIONI 5

# PËRKUFIZIMI I DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE



### OBJEKTIVAT:

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit/et do të jenë në gjendje të:

1. Kuptojnë përkufizimin bazik dhe universal të dhunës në bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave
2. Kuptojnë format dhe intensitetin e dhunës në bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave



### HAPAT:

- A. Përkufizimi për Dhunën në Bazë Gjinore dhe Dhunës ndaj Grave
- B. Format dhe Intensiteti i Dhunës në Bazë Gjinore dhe Dhunës ndaj Grave



### MATERIALET:

- Tabelë dhe Letër
- Laps
- Letër për shënime



### FLETËPALOSJET:

- 1 – Përkufizimi i Dhunës në Bazë Gjinore dhe Dhunës ndaj Grave
- 2 – Format dhe Intensiteti i Dhunës në Bazë Gjinore dhe Dhunës ndaj Grave

## A. PËRKUFIZIMI I DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE

### Hapi A1

Pyesni pjesëmarrësit/et se si e kuptojnë dhunën në bazë gjinore dhe dhunën ndaj grave.

### Hapi A2

Shkruani perceptimet e pjesëmarrësve/eve në tabelë.

### Step A3

Shpërndani Fletëpalosjen 1 tek pjesëmarrësit/et dhe diskutoni pikat kryesore.

## SESIONI 5 – FLETËPALOSJA 1 – PËRKUFIZIMI I DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE

Dhuna në Bazë Gjinore (ang. GBV) përfshinë dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike të rrënjosur në rolet dhe identitetet gjinore të individëve. Dhuna ndaj grave dhe vajzave është formë e shpeshtë e dhunës në bazë gjinore dhe një nga shkeljet më të përhapura të drejtave të njeriut; vlerësohet që 1 në 3 gra do të përjetojnë dhunë fizike apo seksuale në jetën e tyre.

Deklarata e BE-së për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (1993) e përkufizon dhunën ndaj grave si “cilindo akt të dhunës në bazë gjinore që rezulton apo ka tendencë të rezultojë në dëm fizik, seksual, apo psikologjik, apo në vuajtje të grave, përfshirë kërcënimet sikurse detyrim apo mohim arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike apo private”.

Kjo përfshinë, por nuk kufizohet në dhunë fizike, seksuale dhe psikologjike që ndodh në familje dhe në komunitetin e përgjithshëm, përfshirë – rrahjen; abuzimin seksual të fëmijëve femra në shtëpi; dhunë që ndërlidhet me prikë; përdhunime martesore; gjymtim gjenital femëror dhe praktika të dëmshme tradicionale për gratë; dhunë jo bashkëshortore; dhunë që ndërlidhet me eksploatim; përdhunim; abuzim seksual; ngacmim seksual dhe kërcënim në punë, në institucione arsimore dhe kudo tjetër; trafikimi tek gratë dhe prostitucioni i detyruar; dhe dhuna e kryer apo falur nga shteti.

Dhuna në bazë gjinore po ashtu mund tu shkaktohet djemve dhe burrave për shkak të identitetit të tyre seksual apo gjinor, dhe shpesh përjetohet nga personat LGBTQ (Lesbikë, Gay, Biseksual, Transgjjinor apo Queer).

*(Burimi: UNHCR 2003)*

## B. FORMAT DHE INTENSITETI I DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE

### Hapi B1

Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të elaborojnë për llojet e dhunës që i kanë parë të jenë ushtruar ndaj grave në shoqëri.

### Hapi B2

Shkruani përgjigjet e pjesëmarrësve/eve në një tabelë. Ndani pjesëmarrësit/et në tri (3) apo katër (4) grupe dhe kërkoni nga secili grup të punojnë në tabelën në vijim:

### TABELA:

Mosha e grave	Forma e dhunës	Dorasit/et	Shkaktarët
Para-lindjes			
Foshnjëri			
Fëmijëri			
Adoleshencë			
Moshë riprodhuese			
Pleqëri			

### Hapi B3

Kërkoni nga grupet ta prezantojnë punën e tyre.

### Hapi B4

Shpërndani Fletëpalosjen 2 tek pjesëmarrësit/et dhe diskutoni format kryesore të dhunës përfshirë në Fletëpalosje.

## SESIONI 5 – FLETËPALOSJA 2 – FORMAT DHE INTENSITETI I DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE

### LLOJET E DHUNËS NDAJ GRAVE:

- Dhuna seksuale – Përdhunim apo përdhunim martesor; abuzim seksual i fëmijëve, njollosje apo incest; sodomi/përdhunim anal; tentim përdhunimi apo tentim i detyruar për sodomi/përdhunim anal; abuzim seksual; eksploatim seksual; prostitucion i detyruar (eksploatim seksual); ngacim seksual; dhuna seksuale si mjet i luftës apo torturës.
- Dhuna fizike – Sulmi fizik; trafikimi, skllavëria.
- Dhuna fizike dhe psikologjike – Abuzimi/Poshtërimi; Burgimi.
- Praktika të dëmshme tradicionale – Gjymtim gjenital femëror (ang. FGM); martesat e hershme; martesat e detyruara; vrasjet në emër të nderit dhe gjymtimet; vrasjet e foshnjave dhe/apo neglizhencë; mohim i arsimimit për vajzat dhe gratë.
- Dhuna socio-ekonomike – Diskriminimi dhe/apo mohimi i mundësive, shërbimeve; përjashtimit shoqëror/dëbimit në bazë të orientimit seksual; praktika bllokuese legjislative.

(Burimi: UNHCR 2003)



## SHKALLA E DHUNËS NDAJ GRAVE:

- Në mbarë botën, deri në 70 % e vrasjeve të grave janë kryer nga partnerët e tyre intim, shpesh në kontekst të një lidhjeje abuzues.
- Rreth botës, së paku një në çdo tri gra është rrahur, detyruar për marrëdhënie seksuale apo abuzuar në një mënyrë tjetër në jetën e saj. Zakonisht, abuzuesi është anëtar i familjes së saj apo dikush i njohur.
- Trafikimi i qenieve njerëzore në mbarë botën është rritur për afro 50 % nga viti 1995 në 2000 dhe vlerësohet që gati 2 milionë gra trafikohen përtej kufijve në bazë vjetore.
- Më shumë se 60 milionë vajza që përndryshe do të pritej të jenë të gjalla apo “të humbura” nga popullata të ndryshme në botë sot, si rezultat i aborteve të njohura si përzgjedhje në bazë të seksit, vrasja e foshnjave femra apo neglizhimi.
- Më shumë se 90 milionë gra dhe vajza afrikane janë viktime të gjymtimit gjenital femëror.
- Këshilli i Evropës ka theksuar që dhuna në familje është shkaktari kryesor i vdekjes dhe aftësive të kufizuara për gratë e grup-moshës 16-44 dhe llogaritet të shkaktoj më shumë vdekje dhe sëmundje të këqija sesa kanceri apo aksidentet në trafik.
- Në SHBA, në vitin 1999 është llogaritur që gratë janë 85 përqind të viktimave të dhunës në familje.
- Qeveria ruse vlerëson që 14, 000 e grave janë vrarë nga partnerët apo të afërmit e tyre në vitin 1999. Prapë se prapë, shteti ende nuk ka ligj që specifikon dhunën në familje.

*(Burimi: UNHCR 2003, Amnesty International 2004)*

**SESIONI**

**6**

RAPORTIMI I MEDIAS  
RRETH GJINISË  
DHE  
DHUNËS  
NDAJ GRAVE

## SESIONI 6

# RAPORTIMI I MEDIAS RRETH GJINISË DHE DHUNËS NDAJ GRAVE



### OBJEKTIVAT:

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit/et do të jenë në gjendje të:

1. Identifikojnë të metat kryesore në raportimin e grave në media.
2. Ekzaminojnë të metat kryesore në raportimin për dhunën ndaj grave në media.



### HAPAT:

- A. Të metat në Raportimin e Grave në Media
- B. Të metat në Raportimin për Dhunën ndaj Grave



### MATERIALET:

- Tabelë dhe Letër
- Laps
- Letër për shënime



### FLETËPALOSJET:

- 1 – Të metat në raportimin e grave në media
- 2 – Të metat në raportimin për dhunën ndaj grave në media.

## A. TË METAT NË RAPORTIMIN E MEDIEVE PËR GRATË

### Hapi A1

Shpërndani letra për shënime tek pjesëmarrësit/et dhe kërkoni nga ta/to t'i identifikojnë cilat lloj lajmesh zakonisht raportohen për gratë.

### Hapi A2

Përgjigjet e tyre të mundshme do të ishin se ata/ato zakonisht raportojnë për gratë kur është fjala për dhunë, bukuri, dhe gara mode. Prezantoni të gjitha përgjigjet në mur.

### Hapi A3

Tani lexoni disa nga përgjigjet dhe diskutoni shkaktarët bazik në raportim të tillë.

### Hapi A4

Shkruani shkaktarët dhe shqyrtoni nëse këta shkaktarë kanë ngjashmëri universale apo nëse dallojnë në rajone e vende të ndryshme.

### Hapi 5

Shpërndani Fletëpalosjen 1 – Të metat e Raportimit për Gratë në Media

## SESIONI 6 – FLETËPALOSJA 1 – TË METAT E RAPORTIMIT PËR GRATË NË MEDIA

Tradicionalisht, mediet në botë kanë qenë të dominuara nga meshkujt, në nivel global dhe kombëtar. Burrat i hartojnë dhe përkufizojnë politikën, prioritetet dhe agjendat e medieve, përfshirë se si gratë portretizohen apo prezantohen. Shpesh janë burrat ata që marrin vendime kur punësohet stafi. Shkalla e punëtorëve meshkuj dhe puntoreve femra në media është shumë e pabalancuar dhe në favor të burrave. Nuk është çudi, atëherë, që mediet janë diskriminuese ndaj grave në shumë fusha. Njëanshmëria ndikon imazhet e grave në media, dhe ka efekt negativ në zhvillimin e grave në shoqëri.

Konstruksioni gjinor në media lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me çështje të ndryshme, përfshirë seksizmin dhe nën-përfaqësimin në media. Faktorë të tjerë të përgjegjshëm për padukshmërinë e grave në organizata të medieve janë shkallë të ulëta të punësimit dhe ngacmimit seksual në vendin e punës.

Edhe pse media po bëhet më përkrahëse për përpjekjeve të grave kundër diskriminimit, diskriminimi dhe pandjeshmëria ekzistuese dhe ndonjëherë në rritje e sipër në këtë industri duhet të ekzaminohet. Fushat shqetësuese në vijim janë identifikuar si pengesat kryesore për media të kujdeshme në kontekstin gjinor.

Shumë revista të grave fokusin e kanë tek shtëpia, kuzhina dhe moda. Këto revista bazohen dukshëm në anën shtëpiake të grave duke provuar të dëshmojnë që secila grua duhet të jetë kuzhinierë, rrobaqepëse, dhe amvise e përsosur, duke qenë edhe e bukur në të njëjtën kohë. Cilësitë intelektuale të grave kurrë nuk përmenden. Aftësitë e tyre si partnere të barabarta për tu zhvilluar humben në mes të shkathtësive në gatim dhe krema të bukurisë. Grave të të gjitha klasave po u shpërlahet truri për të performuar detyrat e tyre riprodhuese më shumë sesa ato produktive, apo ta bëjnë bukurinë fizike prioritetin kryesor.

Media zakonisht nuk e ka problem që t'i ekspozojë tiparet fizike dhe seksuale të grave, por heziton të sjellë përpara çështje që ndërlidhen me ngacmimet seksuale, tregtinë e seksit dhe trafikimin e qenie njerëzore. Kjo ndodhë pavarësisht faktit që secila nga këto çështje lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me varfëri, pozitën inferiore të grave në shoqëri dhe mohimin e të drejtave themelore të njeriut.

Thuhet që "gjinjtë e zbuluar përdoren për të shitur çdo gjë, qoftë pije, xhinse, rubineta kuzhine, vetura, barna, lëngje." Argumentohet që shumë reklama që e adresojnë pajisjet konsumuese shtëpiake i portretizojnë gratë në role stereotipike që i kufizojnë aftësitë e tyre. Kjo është e vërtetë në masë të gjerë, dhe ky trend ka ekzistuar për një kohë të gjatë; gratë janë objekte të bukurosisë dhe nëse u mungon ajo, ato duhet të bëjnë gjithçka për ta arritur atë që u mungon.

Mediet po ashtu i portretizojnë imazhet tipike të shoqërisë për një "burrë të vërtetë" si një djalë maço. Kjo mund të shihet përmes reklamimit eksplicit të të gjitha llojeve si "barna seksi". Në duhet t'i shikojmë tek pyetjet e seksualitetit mashkullor dhe reklamave në gazeta dhe të analizojmë lidhjet ndërmjet këtyre reklamave dhe akteve të dhunës dhe stereotipet e dëmshme për meshkujt/femrat në shoqëri.

## B. TË METAT NË RAPORTIMIN E DHUNËS NDAJ GRAVE

### Hapi B1

Ndani pjesëmarrësit/et në katër (4) grupe dhe u caktoni detyrën në vijim:

#### DETYRA B1

1. Identifikoni të metat kryesore në raportimin për dhunën ndaj grave që tregojnë për kontrastet gjinore.
2. Shkruani fjalët dhe fjalitë e papërshtatshme që i përdorim gjatë raportimit të dhunës ndaj grave.
3. Shkruani për disbalancet në raportimin e lajmeve kur hetohet dhe raportohet për dhunën ndaj grave.

### Hapi B2

Lejoni secilin grup t'i prezantojë përfundimet e tyre. Lehtësoni diskutimin në grup të madh duke i përdorur pyetjet në vijim:

- Cilat janë disa nga porositë që këto mite, tregime, etj., japin për gratë dhe burrat?
- Si ndikojnë ato në ndjenjat e tua për vetveten?
- Si ndikojnë ato në ndjenjat e tua për gratë dhe burrat?
- Cilat janë disa nga rezultatet e pengesave shoqërore dhe kulturore të shkaktuara nga stereotipet?
- A i përjetojnë gratë dhe burrat këto pengesa në mënyrë të njëjtë apo të ndryshme? Si ndikojnë këto barrierat në raportet e tyre?

## **SESIONI 6 – FLETËPALOSJA 2 – RAPORTIMI NË MEDIA PËR DHUNËN NDAJ GRAVE**

Raportimi për dhunën ndaj grave, përfshirë mizoritë shtëpiake dhe institucionale, ka nevojë për përmirësim të konsiderueshëm. Shumë gazeta raportojnë njëanshmërisht kundër këtyre grave dhe përforcojnë qëndrimin ekzistues jo-përkrahës të shoqërisë ndaj grave. Vërehet që shumë herë mbijetuesit/et e akteve të dhunës i janë ekspozuar një poshtërimi të dyfishtë me mbulim të gjerë dhe shumë shpesh të panevojshëm.

**SESIONI**





NJOHURI DHE  
AFTËSI TË  
PËRMIRËSUARA  
& ETIKA E NDJESHME  
GJINORE NË MEDIA

## SESIONI 7

# NJOHURI DHE AFTËSI TË PËRMIRËSUARA & ETIKA E NDJESHME GJINORE NË MEDIA



### OBJEKTIVAT:

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit/et do të jenë në gjendje të:

1. Mësojnë për ligjet lokale në lidhje me dhunën në bazë gjinore.
2. Përvetësojnë një ndjenjë për etikë të ndjeshme gjinore në media.



### HAPAT:

- A. Ligjet Lokale në Lidhje me Dhunën në Bazë Gjinore
- B. Etika e ndjeshme gjinore në media



### MATERIALET:

- Tabelë dhe Letër
- Laps



### FLETËPALOSJET:

- 1 - Ligjet Lokale në Lidhje me Dhunën në Bazë Gjinore
- 2 – Sugjerime rreth Etikës të ndjeshme gjinore

## A. LIGJET LOKALE NË LIDHJE ME DHUNËN NË BAZË GJINORE

### Hapi A1

Pyetni pjesëmarrësit/et se sa janë të familjarizuar/a me ligjet lokale në vendin e tyre për format e ndryshme të dhunës në bazë gjinore sikurse dhuna seksuale, dhuna në familje, etj.

### Hapi A2

Ndani Fletëpalosjen 1 me grupin.

### Hapi A3

Pasi të keni lexuar Fletëpalosjen 1, diskutoni opinionet rreth qëllimit dhe dispozitave të ligjeve në krahasim me ato që kanë mësuar në sesionet e kaluara. Pyetni ata/ato se çka mendojnë për zbatimin e këtyre ligjeve në praktikë.

## SESIONI 7 – FLETËPALOSJA 1 – LIGJET LOKALE NË LIDHJE ME DHUNËN NË BAZË GJINORE

**SHËNIM:** Përmbajtjet e Fletëpalosjeve për ligjet lokale në lidhje me dhunën në bazë gjinore duhet të ofrohen posaçërisht para trajnimit nga organizata partnere lokale në secilin shtet individual.

## B: ETIKA E NDJESHME GJINORE NË MEDIA

### Hapi B1

Pyetni pjesëmarrësit/et gazetarët/et nëse ndonjë lajm i prodhuar gjatë karrierës së tyre në gazetari ka ofruar ndonjë lloj lehtësimi për mbijetueset e dhunës në bazë gjinore.

### Hapi B2

Pasi t'i keni diskutuar disa nga rastet studimore për lehtësimin e ofruar për viktimat si rezultat i ndonjë lajmi, kërkoni nga pjesëmarrësit/et t'i ndajnë shembujt ku reportazhet kanë pasojë negative të paqëllimshme.

### Hapi B3

Pasi t'i keni diskutuar aspektet pozitive dhe negative të reportazheve, diskutoni rëndësinë e kodit të sjelljes për të siguruar që raportet e përgatitura nga gazetarët/et do të

ishin të dëmshme për cilindo sektor të shoqërisë, përfshirë gratë.

### Hapi B4

Diskutoni me pjesëmarrësit/et aspektet që duhet të mbulohen në kodin e etikës për media. Pasi t'i keni shkruar sugjerimet, ndani Fletëpalosjen 2 me ta.

### Hapi B5

Pasi të keni lexuar Fletëpalosjen 2, diskutoni përmbajtjen me pjesëmarrësit/et. Pas asaj, bashkojuni pjesëmarrësve/eve në punën në grup për të përsëritur reportazhet e diskutuara më parë duke i përdorur sugjerimet e ofruara në Fletëpalosjen 2. Diskutoni dallimet ndërmjet versionit original dhe atij të rishikuar dhe mësimet e mësuara.

## SESIONI 7 – FLETËPALOSJA 2 – SUGJERIME PËR ETIKËN E RAPORTIMIT NË MEDIA

Dhuna ndaj grave dhe familjes dhe dhuna ndërmjet partnerëve nuk përbëjnë thjeshtë një problemin të vetëm të izoluar dhe privat. Ato gjithmonë duhet të raportohen brenda kontekstit të përgjegjësive sociale për të mbrojtur të drejtat themelore të njeriut për ekzistencë të sigurtë dhe të lirë dhe raporte jo të dhunshme shoqërore dhe private. Të gjitha shoqëritë kanë përgjegjësi të krijojnë politika publike me “tolerancë zero” për cilëndo formë të dhunës.

Raportimi në media duhet t’i shmangët përdorimit të stereotipeve për karakteristikat “femërore” dhe rolet dhe komentet që në mënyrë indirekte fokusohen në moralet e mbijetuesëve, partnerit të saj të mëparshëm apo historisë martesore, etj. Këto mund të orientojnë publikun drejt një opinioni për “arsyetimin” e dhunës, apo t’ia zvogëlojnë rëndësinë e krimit të kryer.

Raportimi medial duhet t’i shmangë komentet apo përshkrimet që mund të përmbajnë qëndrime diskriminuese drejt grupeve specifike, me fjalë të tjerë të lë të nënkuptohet që dhuna në familje dhe/apo dhuna ndaj grave është karakteristikë sjelljeje “e zakonshme” apo “më e zakonshme” në kontekste të caktuara etnike, kulturore apo shoqërore. Nacionaliteti i të mbijetuarave apo kryerësve përmendet në artikuj kryesisht në lidhje me anëtarët e grupit të minoritetit dhe kurrë në lidhje me anëtarët e grupit shumicë, edhe pse ky tipar personal nuk ndërlidhet në asnjë mënyrë me dhunën.

Njohuri më e mirë për këtë fenomen do ta ulte nevojën për shpjegime stereotipike të sjelljes së dhunshme – “alkoolizmi”, “varfëria”, “xhelozia” etj, si shkaktarë të dhunës. “Romantizimi” i nje raporti që përfundon në mënyrë tragjike, me vrasje apo vetëvrasje të partneres femër, është krejtësisht e papërshtatshme.

Përshkrimet e situatave të dhunshme që përfshijnë provokimin nga ana e partneres femër, apo fjalë e komente që lënë të nënkuptohet se mbijetuesja e “provokoi” dhe “tundoj” me sjelljen e saj, apo “nuk bëri asgjë që ta mbroj vetën”, krijojnë përshtypjen që dhuna arsyetohet apo zvogëlohet, që mbijetuesja fajësohet dhe që përgjegjësia është e saj. Në të njëjtën kohë, raportimi duhet po ashtu t’i shmangët konstrukteve sikurse “për arsye që nuk dihen”, sepse atom und të sugjerojnë që ka arsye “legjitime” për dhunë, si dhe konstrukte sikurse “tragjedia ndodhi” që sugjerojnë që dhuna “ndodhi” (vetë), duke e errësuar përgjegjësinë e kryerësit.

Përshkrimi i dhunës si “grindje”, “konflikt”, “argument”, “përleshje”, “mosmarrëveshje martesore”, “raporte të pazgjidhura familjare” apo “vrasje brutale e shkaktuar nga argumentet rreth fëmijëve”, jo vetëm që miraton keqkuptimet e shkaktarëve dhe natyrës së dhunës, por po ashtu e bën relative përgjegjësinë e kryerësit të dhunës, duke sugjeruar që përbëhet nga agresioni ndërmjet palëve që kanë pushtet dhe pozita të barabarta dhe në këtë mënyrë përgjegjësi të barabarta (të ngjashme).

Rëndësi e veçantë duhet t’i kushtohet fjalëve dhe konstrukteve të përdorura për tituj të artikujve apo raportimit të lajmërimeve, sepse sugjerojnë që raportet e audiencës për problemin/përmbajtjen e raportit. Titujt e papërshtatshëm mund ta reduktojnë përgjegjësinë dhe pasojat e vërteta të aktit (për shembull, vrasjes). Redaktori/ja ka përgjegjësi të siguroj tituj të përgjegjshëm për artikujt që përshkruajnë dhunën ndaj grave.

*(Burimi: „Udhëzim për Gazetarët – Dhuna në Familje”  
Autonomous Women’s Center 2008)*

# SESIONI 7 (a)

—

\*Opsional\*

## SESIONI 7(a)

—

**\*Opsional\***

**SHËNIM:** Sesionet në trajnim janë hartuar për një audiencë të matur të gazetarëve/eve profesionistë/e. Megjithatë, nëse grupi i pjesëmarrësve/eve përbëhet nga studentë/e të gazetarisë, është një seksion opsional që mund të përdoret si pjesë shtesë e përshtatshme për fillestarët/et në media, që mbulon teknikat e raportimit të mirë.



### **OBJEKTIVAT:**

Në fund të këtij sesioni, pjesëmarrësit/et do të jenë në gjendje të:

3. Mësojnë teknikat e raportimit të mirë.



### **HAPAT:**

C. Teknikat e Raportimit të Mirë



### **MATERIALET:**

- Tabelë dhe Letër
- Laps



### **FLETËPALOSJET:**

3. Teknikat e Raportimit të Mirë

## C. TEKNIKAT E RAPORTIMIT TË MIRË

### Hapi C1

Pyesni pjesëmarrësit/et: Cilat janë shkathtësitë dhe teknikat të nevojshme për një gazetar/e?

### Hapi C2

Shkruani përgjigjet e pjesëmarrësve/eve dhe vazhdoni diskutimin.

### Hapi C3

Shkruani një përmbledhje të një reportazhi për dhunën ndaj grave në një tabelë. Ndani pjesëmarrësit/et në grupe të

ndryshme dhe kërkoni nga grupet të zhvillojnë atë në një reportazh të plotë duke i përdorur shkathtësitë e tyre.

### Hapi C4

Lejoni grupet të prezantojnë reportazhet e tyre dhe të hapin forumin për debat për mospërputhjet në ato reportazhe.

### Hapi C5

Identifikoni dhe shkruani mospërputhjet në tabelë dhe diskutoni mënyrat e mundshme për t'i përmirësuar ato sipas Fletëpalosjes 3 pasi të keni shpërndarë atë tek pjesëmarrësit/et.

## \* SESIONI 7A (\*OPSIONAL\*) – FLETËPALOSJA 3 – TEKNIKAT E RAPORTIMIT TË MIRË \*

### BALANCI DHE SAKTËSIA

Përderisa gazetarët/et mësojnë teknika dhe shkathtësi të reja për mbulim të vazhdueshëm të çështjeve në shoqëri, kjo njohuri do të duhej të reflektonte në tregimet e medieeve. Parimet e raportimit të mirë në media janë si në vijim:

- Saktësia
- Balanci
- Shkrim i qartë dhe konciz
- I fokusuar mirë
- Diversitet i burimeve
- Konteksti

Saktësia është një nga karakteristikat dalluese të profesionit. Gjatë shkrimit të lajmeve, analizimit të lajmeve apo reportazheve një gazetar/e duhet gjithnjë të prezantojë fakte e jo opinionet, njëanshmëritë apo paragjykimet e tij apo saj. Gazetarët/et nuk duhet kurrë ta lakojnë, shtrembërojnë apo krijojnë “të vërtetën”.

Balanci krijohet duke ofruar diversitet të burimeve në reportazh dhe duke siguruar që njëanshmëritë apo interesat e vet gazetarëve/eve të mos ndikojnë në atë se cilat fakte përfshihen apo përjashtohen dhe kush intervistohet apo nuk intervistohet. Në një program trajnues IPS (Inter Press Service) në vitin 1996, për çështjet gjinore në media, gazetarët/et e pranuan që gratë shpesh nuk janë intervistuar sepse besimet e vetë gazetarëve/eve, përfshirë “gratë nuk dijnë asgjë për ekonominë”. Ky diskriminim ka bërë që gazetarët/et të mos i përfshijnë gratë

si burime, gjë që ka krijuar mos-balanc në atë se kush po flet në reportazhet e tyre – kryesisht burrat. Balanci po ashtu nënkupton të ofrohen të gjitha anët e një çështjeje, duke e vendosur pikëvështrimin dominues dhe ato konfliktuoze apo plotësuese. Prezantimi i saktë i fakteve, pozicionimi i çështjes brenda situatës lokale, rajonale apo globale, dhe përdorimi i të dhënave relevante janë vetëm disa në mënyrat kyçe për t'i ofruar kontekst një reportazhi.

Gjuha e qartë dhe koncize ndihmon që gazetarët/et që ta komunikojnë çështjen të cilën po e raportojnë. Duke e kuptuar terminologjinë dhe duke e shpjeguar “zhargonin”, gazetarët/et i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të shkrimit duke gjetur mënyra më efektive për t'ia shpjeguar një çështje publikut.

## PIKËPYETJE PËR GJITHÇKA

Përveç shkathtësive të përmendura më lartë, gazetari/ja po ashtu duhet të theksojë shkathtësitë e tij apo saj për “ta vënë në pikëpyetje urtësinë konvencionale”. Një gazetar/e duhet të fillojë t'i qaset informacionit me një dozë të shëndoshë skepticizmi. “A i besoj premisë bazike?” është pyetje që gazetari/ja duhet ta bëjë.

Për shembull, gjinia sipas përkufizimit është konstrukt shoqëror, jo “e vërtetë absolute”, dhe mund të ndryshohet. Për të folur për gjininë apo për t'i sjellë perspektivat gjinore në reportazh në mënyrë konsistente, është mënyrë për ta sfiduar urtësinë konvencionale për rolet e burrave dhe grave, përderisa shqyrtimi konstant i relacioneve gjinore në çështjet që raportohen është mënyrë për ta sfiduar pabarazinë.

## TË KUPTUARIT E TË DHËNAVE

Gazetarët/et duhet të rrisin aftësitë e tyre për të kuptuar dhe për t'i përdorur të dhënat në mënyrë korrekte. Pikat në vijim duhet mbajtur në mend:

- Kur raportohen statistikat, kini kujdes të kuptoni në mënyrë precize çka nënkuptojnë numrat. Lehtë mund të humbni rëndësinë e vërtetë të një statistike dhe rrjedhimisht të raportoni informacionin e gabuar.
- Kërkoni burimin e statistikave, besueshmërinë e tyre dhe afatin kohor të informacionit.
- Sigurohuni të shpjegoni cilindo dallim dhe mospërputhje. Statistikat mund të duken kontradiktore. Megjithatë, ato janë zakonisht të ndryshme për arsye legjitime. Për shembull, grupe të ndryshme të popullsisë mund të jenë përfshirë në një anketë apo të dhënat mund të jenë nga periudha të ndryshme kohore.
- Siguroni data për të dhënat. Studimet e dala një vit e më shumë më parë jo domosdo janë të vjetra. Disa studime zgjasin me muaj apo vite për tu realizuar, pas të cilave të dhënat duhet analizuar. Edhe nëse statistikat ndërliken me studimin (sikurse një anketë kombëtare) ka filluar disa vite më parë, ato mund të jenë aktuale nëse vetëm sa kanë dalë.



## VERIFIKIMI I FAKTEVE DHE I INFORMACIONIT

Duke e pasur parasysh se sa i komplikuar është raportimi për dhunën ndaj grave, është shumë me rëndësi që gazetarët/et ta verifikojnë informacionin të cilin e hasin gjatë një interviste, në publikime zyrtare apo në hulumtime dhe dokumente të tjera. Raportimi i mirë për dhunën ndaj grave vetëm do të shfaqet kur një gazetar/e i kupton mirë çështjet. Kjo zhvillohet përmes verifikimit të vazhdueshëm për të siguruar saktësi. Kur një gazetar/e has në informacione dhe statistika në publikime kombëtare, ato duhet të verifikohen me statistikat në dokumente të BE-së, për shembull, dhe anasjelltas. Kjo ndihmon që gazetari apo gazetarja të verifikojnë shifrat dhe të zbulojnë mospërputhjet në informacion. Kur mospërputhjet detektohen, gazetari/ja duhet të kërkojë t'i qartësojë ato para se t'i përdorë shifrat si "fakte" apo "njohurinë e përgjithshme" në një reportazh.

Gazetarët/et duhet po ashtu të shmangen nga raportimi i të gjeturave hulumtuese pa i shqyrtuar faktorët që mund t'i kenë ndikuar rezultatet. Gazetarët/et duhet ta përvetësojnë një skepticizëm të përgjithshëm për hulumtime që përkthehen në pyetjet rreth burimit të hulumtimit dhe qëllimit të tij. Gazetari/ja duhet t'i bëjë pyetjet në vijim: A ka qenë i sponsorizuar hulumtimi? Nga kush apo nga cila organizatë? Cila metodologji e hulumtimit është përdorur? A lidhen të gjeturat me statistikat?



## SESIONI 1 – FLETËPALOSJA – OBJEKTIVAT E PUNËTORISË

Objektivat e punëtorisë janë si në vijim:

- Të shtojë ndjeshmërinë për çështje gjinore duke shpjeguar më mirë konceptet ‘seks’ dhe ‘gjini’.
- Të shpjegojë përkufizimin e dhunës në bazë gjinore dhe mënyrat dhe metodat e dhunës në bazë gjinore.
- Të diskutojë mangësitë e përgjithshme të raportimit të çështjeve të grave, veçanërisht të dhunës ndaj grave.
- Të përmirësojë shkathhtësitë dhe cilësinë e raportimit të dhunës në bazë gjinore në media.

## SESIONI 2 – FLETËPALOSJA 1 – MEDIA E PAVARUR

*„Një gazetë (medium) e pavarur është ndërmjetësues i sinqertë i informacionit për lexuesit pa njëanshmëri apo favorizim të qëllimshëm. Një gazetë e pavarur (medium) konsideron se pavarësia e saj është aseti më i vlefshëm komercial, editorial dhe moral. Ajo e ruan pavarësinë e saj në mënyrë që të mund t’i flas të gjithë anëtarëve të audiencës gjatë gjithë kohës. Ajo mirëmban pavarësinë përmes sjelljes profesionale, dhe principet i bën të njohura për të gjithë të punësuarit (politikë konkrete) dhe për të gjithë lexuesit apo klientët komercial që duan ta njohin. Një gazetë e pavarur (medium) nuk i bazon vendimet profesionale në interesa të ngushta ekonomike apo politike për asnjë grup, përfshirë vetveten.”*

## SESIONI 2 – FLETËPALOSJA 2 –PAVARËSIA EDITORIALE

Pavarësia editoriale qendron në thelb të lirisë së shtypit, gjë kjo që nënkupton pavarësi nga forcat jashtë dhe brenda medias, specifikisht nga:

1. Qeveria
2. Partitë politike dhe interesat
3. Interesat komerciale dhe biznesore, përfshirë këtu interesat e reklamuesve/eve
4. Miqtë/miket e gazetarëve/eve
5. Paragjykimet, bestytnitë dhe anshmëritë e vetë gazetarëve/eve

### SESIONI 3 – FLETËPALOSJA – SEKSI DHE GJINIA

Konceptet “seksi” dhe “gjinia” mund të përkufizohen si në vijim:

**SEKSI:** I referohet dallimeve biologjike ndërmjet grave dhe burrave. Dallimet janë në përgjithësi të përhershme dhe universale.

**GJINIA:** I referohet roleve dhe përgjegjësive të formësuara në mënyrë shoqërore për gratë dhe burrat në një kulturë apo lokacion.

Këto role ndikohen nga perceptimet dhe pritshmëritë që vijnë nga faktorët kulturorë, politikë, ambientalë, ekonomikë, shoqërorë, fetarë, si dhe nga zakonet, ligjet, klasa, etnia, dhe anësitë individuale apo institucionale. Qëndrimet rreth gjinisë dhe sjelljeve mësohen dhe mund të ndryshohen.

*Cilat janë disa nga situatat ku i shohim dallimet gjinore?*

**SHOQËRORE:** Perceptime të ndryshme për rolet shoqërore të grave dhe burrave: burri, si kryefamiljar dhe ai i cili i sjellë paratë në familje; gruaja, ajo që ushqen dhe përkujdeset për të tjerët.

**POLITIKE:** Dallimet në mënyrat se si gratë dhe burrat e supozojnë dhe e ndajnë pushtetin dhe autoritetin: burrat janë më të përfshirë në nivelin kombëtar dhe të lartë politik; gratë më të përfshira në nivel lokal në aktivitete që ndërlidhen me rolet e tyre shtëpiake.

**ARSIMORE:** Dallimet në mundësi dhe pritshmëritë arsimore për vajzat dhe djemtë: burimet familjare të drejtuara tek arsimimi i djemve sesa i vajzave; vajzat e drejtuara kah linja akademike më pak sfiduese.

**EKONOMIKE:** Dallimet në qasje për gratë dhe burrat në karriera fitimprurëse dhe kontroll rreth financave dhe burime të tjera produktive: kredi dhe hua; pronësi toke.

## SESIONI 4 – FLETËPALOSJA – STEREOTIPET E ZAKONSHME GJINORE

Lista e Stereotipeve të Zakonshme për Femrat dhe Meshkujt

Gratë janë:	Burrat janë:
Të varura	Të pavarur
Të dobëta	Të pushtetshëm
Të paafta	Të aftë
Më pak të rëndësishme	Më të rëndësishëm
Emocionale	Logjik
Zbatuese	Vendimmarrës
Amvise	Kryefamiljar
Përkrahëse	Udhëheqës
Fragjile	Mbrojtës
Labile	Konsistent
Frikacake	Të guximshëm
Paqësore	Agresivë
Të kujdesshme	Aventurier
Fleksibile	Të fokusuar
Të ngrohta	Bazohen në vetveten
Pasive	Aktive
Përcjellëse	Udhëheqës
Spektatore	Veprues
Modeste	Ambiciozë
Subjektive	Objektive
Flasin butësisht	Flasin lirshëm
Sekretare	Bosa
Ushqyese	Të vendosur
Të buta	Të fortë
Ngacmohen lehtë	Stoikë
Të durueshme	Të vrullshëm
Gazmore	Energjikë
Përkujdesëse	Realizues
Bashkëpunuese	Garues

## **SESIONI 5 – FLETËPALOSJA 1 – PËRKUFIZIMI I DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE**

Dhuna në Bazë Gjinore (ang. GBV) përfshinë dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike të rrënjëzuar në rolet dhe identitetet gjinore të individëve. Dhuna ndaj grave dhe vajzave është formë e shpeshtë e dhunës në bazë gjinore dhe një nga shkeljet më të përhapura të drejtave të njeriut; vlerësohet që 1 në 3 gra do të përjetojnë dhunë fizike apo seksuale në jetën e tyre.

Deklarata e BE-së për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (1993) e përkufizon dhunën ndaj grave si “cilindo akt të dhunës në bazë gjinore që rezulton apo ka tendencë të rezultojë në dëm fizik, seksual, apo psikologjik, apo në vuajtje të grave, përfshirë kërcënimet sikurse detyrim apo mohim arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike apo private”.

Kjo përfshinë, por nuk kufizohet në dhunë fizike, seksuale dhe psikologjike që ndodh në familje dhe në komunitetin e përgjithshëm, përfshirë – rrahjen; abuzimin seksual të fëmijëve femra në shtëpi; dhunë që ndërlihet me prikë; përdhunime martesore; gjymtim gjenital femëror dhe praktika të dëmshme tradicionale për gratë; dhunë jo bashkëshortore; dhunë që ndërlihet me eksploatim; përdhunim; abuzim seksual; ngacmim seksual dhe kërcënim në punë, në institucione arsimore dhe kudo tjetër; trafikimi tek gratë dhe prostitucioni i detyruar; dhe dhuna e kryer apo falur nga shteti.

Dhuna në bazë gjinore po ashtu mund tu shkaktohet djemve dhe burrave për shkak të identitetit të tyre seksual apo gjinor, dhe shpesh përjetohet nga personat LGBTQ (Lesbikë, Gay, Biseksual, Transgjjinor apo Queer).

*(Burimi: UNHCR 2003)*

## SESIONI 5 – FLETËPALOSJA 2 – FORMAT DHE INTENSITETI I DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE

### LLOJET E DHUNËS NDAJ GRAVE:

- Dhuna seksuale – Përdhunim apo përdhunim martesor; abuzim seksual i fëmijëve, njollosje apo incest; sodomi/përdhunim anal; tentim përdhunimi apo tentim i detyruar për sodomi/përdhunim anal; abuzim seksual; eksploatim seksual; prostitucion i detyruar (eksploatim seksual); ngacmim seksual; dhuna seksuale si mjet i luftës apo torturës.
- Dhuna fizike – Sulmi fizik; trafikimi, skllavëria.
- Dhuna fizike dhe psikologjike – Abuzimi/Poshtërimi; Burgimi.
- Praktika të dëmshme tradicionale – Gjymtim gjenital femëror (ang. FGM); martesat e hershme; martesat e detyruara; vrasjet në emër të nderit dhe gjymtimet; vrasjet e foshnjave dhe/apo neglizhencë; mohim i arsimimit për vajzat dhe gratë.
- Dhuna socio-ekonomike – Diskriminimi dhe/apo mohimi i mundësive, shërbimeve; përjashtimit shoqëror/dëbimit në bazë të orientimit seksual; praktika bllokuese legjislative.

(Burimi: UNHCR 2003)

### SHKALLA E DHUNËS NDAJ GRAVE:

- Në mbarë botën, deri në 70 përqind e vrasjeve të grave janë kryer nga partnerët e tyre intim, shpesh në kontekst të një lidhjeje abuzues.
- Rreth botës, së paku një në çdo tri gra është rrahur, detyruar në marrëdhënie seksuale, apo e abuzuar në një mënyrë tjetër në jetën e saj. Zakonisht, abuzuesi/ja është anëtar/e i/e familjes së saj apo dikush i njohur.
- Trafikimi i qenieve njerëzore në mbarë botën është rritur për afro 50 përqind nga viti 1995 në 2000 dhe vlerësohet që gati 2 milionë gra trafikohen përtej kufijve në bazë vjetore.
- Më shumë se 60 milionë vajza që përndryshe do të pritej të jenë të gjalla apo “të humbura” nga popullata të ndryshme në botë sot, si rezultat i aborteve të njohura si përzgjedhje në bazë të seksit, vrasja e foshnjave femra apo neglizhimi.
- Më shumë se 90 milionë gra dhe vajza afrikane janë viktimat të gjymtimit gjenital femëror.
- Këshilli i Evropës ka theksuar që dhuna në familje është shkaktari kryesor i vdekjes dhe aftësive të kufizuara për gratë e grup-moshës 16-44 dhe llogaritet të shkaktoj më shumë vdekje dhe sëmundje të këqija sesa kanceri apo aksidentet në trafik.
- Në SHBA, në vitin 1999 është llogaritur që gratë janë 85 përqind të viktimave të dhunës në familje.
- Qeveria ruse vlerëson që 14, 000 e grave janë vrarë nga partnerët apo të afërmit e tyre në vitin 1999. Prapë se prapë, shteti ende nuk ka ligj që specifikon dhunën në familje.

(Burimi: UNHCR 2003, Amnesty International 2004)

## SESIONI 6 – FLETËPALOSJA 1 – TË METAT E RAPORTIMIT PËR GRATË NË MEDIA

Tradicionalisht, mediet në botë kanë qenë të dominuara nga meshkujt, në nivel global dhe kombëtar. Burrat i hartojnë dhe përkufizojnë politikën, prioritetet dhe agjendat e medieeve, përfshirë se si gratë portretizohen apo prezantohen. Shpesh janë burrat ata që marrin vendime kur punësohet stafi. Shkalla e punëtorëve meshkuj dhe femra në media është shumë e pabalancuar dhe në favor të burrave. Nuk është çudi, atëherë, që mediet janë diskriminuese ndaj grave në shumë fusha. Njëanshmëria ndikon imazhet e grave në media, dhe ka efekt negativ në zhvillimin e grave në shoqëri.

Konstruksioni gjinor në media lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me çështje të ndryshme, përfshirë seksizmin dhe nën-përfaqësimin në media. Faktorë të tjerë të përgjegjshëm për padukshmërinë e grave në organizata të medieeve janë shkallë të ulëta të punësimit dhe ngacmimit seksual në vendin e punës.

Edhe pse media po bëhet më përkrahëse për përpjekjeve të grave kundër diskriminimit, diskriminimi dhe pandjeshmëria ekzistuese dhe ndonjëherë në rritje e sipër në këtë industri duhet të ekzaminohet. Fushat shqetësuese në vijim janë identifikuar si pengesat kryesore për media të kujdesshme në kontekstin gjinor.

Shumë revista të grave fokusin e kanë tek shtëpia, kuzhina dhe moda. Këto revista bazohen dukshëm në anën shtëpiake të grave duke provuar të dëshmojnë që secila grua duhet të jetë kuzhinierë, rrobaqepëse, dhe amvise e përsosur, duke qenë edhe e bukur në të njëjtën kohë. Cilësitë intelektuale të grave kurrë nuk përmenden. Aftësitë e tyre si partnere të barabarta për tu zhvilluar humben në mes të shkathtësive në gatim dhe krema të bukurisë. Grave të të gjitha klasave po u shpërlahet truri për të performuar detyrat e tyre riprodhuese më shumë sesa ato produktive, apo ta bëjnë bukurinë fizike prioritetin kryesor.

Media zakonisht nuk e ka problem që t'i ekspozojë tiparet fizike dhe seksuale të grave, por heziton të sjellë përpara çështje që ndërlidhen me ngacmimet seksuale, tregtinë e seksit dhe trafikimin e qenie njerëzore. Kjo ndodhë pavarësisht faktit që secili nga këto çështje lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me varfëri, pozitën inferiore të grave në shoqëri dhe mohimin e të drejtave themelore të njeriut.

Thuhet që “gjinjtë e zbuluar përdoren për të shitur çdo gjë, qoftë pije, xhinse, rubineta kuzhine, vetura, barna, lëngje.” Argumentohet që shumë reklama që e adresojnë pajisjet konsumuese shtëpiake i portretizojnë gratë në role stereotipike që i kufizojnë aftësitë e tyre. Kjo është e vërtetë në masë të gjerë, dhe ky trend ka ekzistuar për një kohë të gjatë; gratë janë objekte të bukurisë dhe nëse u mungon ajo, ato duhet të bëjnë gjithçka për ta arritur atë që u mungon.

Mediet po ashtu i portretizojnë imazhet tipike të shoqërisë për një “burrë të vërtetë” si një djalë maço. Kjo mund të shihet përmes reklamimit eksplicit të të gjitha llojeve si “barna seksi”. Në duhet t'i shikojmë tek pyetjet e seksualitetit mashkullor dhe reklamave në gazeta dhe të analizojmë lidhjet ndërmjet këtyre reklamave dhe akteve të dhunës dhe stereotipet e dëmshme për meshkujt/femrat në shoqëri.



## **SESIONI 6 – FLETËPALOSJA 2 – RAPORTIMI NË MEDIA PËR DHUNËN NDAJ GRAVE**

Raportimi për dhunën ndaj grave, përfshirë mizoritë shtëpiake dhe institucionale, ka nevojë për përmirësim të konsiderueshëm. Shumë gazeta raportojnë njëanshmërisht kundër këtyre grave dhe përforcojnë qëndrimin ekzistues jo-përkrahës të shoqërisë ndaj grave. Vërehet që shumë herë mbijetuesit/et e akteve të dhunës i janë ekspozuar një poshtërimi të dyfishtë me mbulim të gjerë dhe shumë shpesh të panevojshëm.

## **SESIONI 7 – FLETËPALOSJA 1 – LIGJET LOKALE NË LIDHJE ME DHUNËN NË BAZË GJINORE**

**SHËNIM:** Përmbajtjet e Fletëpalosjeve për ligjet lokale në lidhje me dhunën në bazë gjinore duhet të ofrohen posaçërisht para trajnimit nga organizata partnere lokale në secilin shtet individual.

## SESIONI 7 – FLETËPALOSJA 2 – SUGJERIME PËR ETIKËN E RAPORTIMIT NË MEDIA

Dhuna ndaj grave dhe familjes dhe dhunës ndërmjet partnerëve nuk përbëjnë thjeshtë një problem të vetëm të izoluar dhe privat. Ato gjithmonë duhet të raportohen brenda kontekstit të përgjegjësive sociale për të mbrojtur të drejtat themelore të njeriut për ekzistencë të sigurt dhe të lirë dhe raporte jo të dhunshme shoqërore dhe private. Të gjitha shoqëritë kanë përgjegjësi të krijojnë politika publike me “tolerancë zero” për cilëndo formë të dhunës.

Raportimi në media duhet t’i shmangët përdorimit të stereotipeve për karakteristikat “femërore” dhe rolet dhe komentet që në mënyrë indirekte fokusohen në moralët e mbijetuesëve, partnerit të saj të mëparshëm apo historisë martesore, etj. Këto mund të orientojnë publikun drejt një opinioni për “arsyetimin” e dhunës, apo t’ia zvogëlojnë rëndësinë e krimin të kryer. Raportimi duhet t’i shmangë komentet apo përshkrimet që mund të përmbajnë qëndrime diskriminuese drejt grupeve specifike, me fjalë të tjerë të lë të nënkuptohet që dhuna në familje dhe/apo dhuna ndaj grave është karakteristikë sjelljeje “e zakonshme” apo “më e zakonshme” në kontekste të caktuara etnike, kulturore apo shoqërore. Nacionaliteti i të mbijetuarave apo kryerësve përmendet në artikuj kryesisht në lidhje me anëtarët e grupit të minoritetit dhe kurrë në lidhje me anëtarët e grupit shumicë, edhe pse ky tipar personal nuk ndërlihet në asnjë mënyrë me dhunën.

Njohuri më e mirë për këtë fenomen do ta ulte nevojën për shpjegime stereotipike të sjelljes së dhunshme – “alkoolizmi”, “varfëria”, “xhelozia” etj, si shkaktarë të dhunës. “Romantizimi” i nje raporti që përfundon në mënyrë tragjike, me vrasje apo vetëvrasje të partneres femër, është krejtësisht e papërshtatshme.

Përshkrimet e situatave të dhunshme që përfshijnë provokimin nga ana e partneres femër, apo fjalë e komente që lënë të nënkuptohet se mbijetuesja e “provokoi” dhe “tundoi” me sjelljen e saj, apo “nuk bëri asgjë që ta mbroj vetën”, krijojnë përshtypjen që dhuna arsyetohet apo zvogëlohet, që mbijetuesja fajësohet dhe që përgjegjësia është e saj. Në të njëjtën kohë, raportimi duhet po ashtu t’i shmangët konstrukteve sikurse “për arsye që nuk dihen”, sepse atom und të sugjerojnë që ka arsye “legjitime” për dhunë, si dhe konstrukte sikurse “tragjedia ndodhi” që sugjeron që dhuna “ndodhi” (vet), duke e errësuar përgjegjësinë e kryerësit.

Përshkrimi i dhunës si “grindje”, “konflikt”, “argument”, “përleshje”, “mosmarrëveshje martesore”, “raporte të pazgjidhura familjare” apo “vrasje brutale e shkaktuar nga argumentet rreth fëmijëve”, jo vetëm që miraton keqkuptimet e shkaktarëve dhe natyrës së dhunës, por po ashtu e bën relative përgjegjësinë e kryerësit të dhunës, duke sugjeruar që përbëhet nga agresioni ndërmjet palëve që kanë pushtet dhe pozita të barabarta dhe në këtë mënyrë përgjegjësi të barabarta (të ngjashme).

Rëndësi e veçantë duhet t’i kushtohet fjalëve dhe konstrukteve të përdorura për tituj të artikujve apo raportimit të lajmërimeve, sepse sugjerojnë që raportet e audiencës për problemin/përmbajtjen e raportit. Titujt e papërshtatshëm mund ta reduktojnë përgjegjësinë dhe pasojat e vërteta të aktit (për shembull, vrasjes). Redaktori/ja ka përgjegjësi të siguroj tituj të përgjegjshëm për artikujt që përshkruajnë dhunën ndaj grave.

(Burimi: „Udhëzim për Gazetarët – Dhuna në Familje”  
Autonomous Women’s Center 2008)

## \* SESIONI 7A (\*OPSIONAL\*) – FLETËPALOSJA 3 – TEKNIKAT E RAPORTIMIT TË MIRË \*

### BALANCI DHE SAKTËSIA

Përderisa gazetarët mësojnë teknika dhe shkathtësi të reja për mbulim të vazhdueshëm të çështjeve në shoqëri, kjo njohuri do të duhej të reflektonte në tregimet e medieve. Parimet e raportimit të mirë në media janë si në vijim:

- Saktësia
- Balanci
- Shkrim i qartë dhe konciz
- I fokusuar mirë
- Diversitet i burimeve
- Konteksti

Saktësia është një nga karakteristikat dalluese të profesionit. Gjatë shkrimit të lajmeve, analizimit të lajmeve apo reportazheve një gazetarë/e duhet gjithnjë të prezantoj fakte sesa opinionet, njëanshmëritë apo paragjykimet e tij apo saj. Gazetarët /et nuk duhet kurrë ta lakojnë, shtrembërojnë apo krijojnë “të vërtetën”.

Balanci krijohet duke ofruar diversitet të burimeve në reportazh dhe duke siguruar që njëanshmëritë apo interesat e vet gazetarëve të mos ndikojnë në atë se cilat fakte përfshihen apo përjashtohen dhe kush intervistohet apo nuk intervistohet. Në një program trajnues IPS (Inter Press Service) në vitin 1996, për çështjet gjinore në media, gazetarët e pranuan që gratë shpesh nuk janë intervistuar sepse besimet e vet gazetarëve, përfshirë “gratë nuk dinë asgjë për ekonominë”. Ky diskriminim ka bërë që gazetarët të mos i përfshijnë gratë si burime, që kanë krijuar mos-balanc në atë se kush po flet në reportazhet e tyre – kryesisht burrat. Balanci po ashtu nënkupton të ofrohen të gjitha anët e një çështjeje, duke e vendosur pikëvështrimin dominues dhe ato konfliktuoze apo plotësuese. Prezantimi i saktë i fakteve, pozicionimi i çështjes brenda situatës lokale, rajonale apo globale, dhe përdorimi i të dhënave relevante janë vetëm disa në mënyrat kyçe për t’i ofruar kontekst një reportazhi.

Gjuha e qartë dhe koncize ndihmon që gazetarët që ta komunikojnë çështjen të cilën po e raportojnë. Duke e kuptuar terminologjinë dhe duke e shpjeguar “zhargonin”, gazetarët/et i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të shkrimit duke gjetur mënyra më efektive për t’ia shpjeguar një çështje publikut.

### PIKËPYETJE PËR GJITHÇKA

Përveç shkathtësive të përmendura më lartë, gazetari/ja po ashtu duhet të theksojë shkathtësitë e tij apo saj për “ta vënë në pikëpyetje urtësinë konvencionale”. Një gazetar/e duhet të fillojë t’i qaset informacionit me një dozë të shëndoshë skepticizmi. “A i besoj premisë bazike?” është pyetje që gazetari/ja duhet ta bëjë. Për shembull, gjinia sipas përkufizimit është konstrukt shoqëror, jo “e vërtetë absolute”, dhe mund të ndryshohet. Për të folur për gjininë apo për t’i sjellë perspektivat gjinore në reportazh në mënyrë konsistente, është mënyrë për ta sfiduar urtësinë konvencionale për rolet e burrave dhe grave, përderisa shqyrtimi konstant i relacioneve gjinore në çështjet që raportohen është mënyrë për ta sfiduar pabarazinë.

## TË KUPTUARIT E TË DHËNAVE

Gazetarët/et duhet të rrisin aftësitë e tyre për të kuptuar dhe për t'i përdorur të dhënat në mënyrë korrekte. Pikat në vijim duhet mbajtur në mend:

- Kur raportohen statistikat, kini kujdes të kuptoni në mënyrë precize çka nënkuptojnë numrat. Lehtë mund të humbni rëndësinë e vërtetë të një statistike dhe rrjedhimisht të raportoni informacionin e gabuar.
- Kërkoni burimin e statistikave, besueshmërinë e tyre dhe afatin kohor të informacionit.
- Siguroni të shpjegoni cilindo dallim dhe mospërputhje. Statistikat mund të duken kontradiktore. Megjithatë, ato janë zakonisht të ndryshme për arsye legjitime. Për shembull, grupe të ndryshme të popullsisë mund të jenë përfshirë në një anketë, apo të dhënat mund të jenë nga periudha të ndryshme kohore.
- Siguroni data për të dhënat. Studimet e dala një vit e më shumë më parë jo domosdo janë të vjetra. Disa studime zgjasin me muaj apo vite për tu realizuar, pas të cilave të dhënat duhet analizuar. Edhe nëse statistikat ndërliken me studimin (sikurse një anketë kombëtare) ka filluar disa vite më parë, ato mund të jenë aktuale nëse vetëm sa kanë dalë.

### VERIFIKIMI I FAKTEVE DHE I INFORMACIONIT

Duke e pasur parasysh se sa i komplikuar është raportimi për dhunën ndaj grave, është shumë me rëndësi që gazetarët/et ta verifikojnë informacionin të cilin e hasin gjatë një interviste, në publikime zyrtare apo në hulumtime dhe dokumente të tjera. Raportimi i mirë për dhunën ndaj grave vetëm do të shfaqet kur një gazetar/e i kupton mirë çështjet. Kjo zhvillohet përmes verifikimit të vazhdueshëm për të siguruar saktësi. Kur një gazetar/e has në informacione dhe statistika në publikime kombëtare, ato duhet të verifikohen me statistikat në dokumente të BE-së, për shembull, dhe anasjelltas. Kjo ndihmon që gazetari apo gazetaria të verifikojë shifrat dhe të zbulojnë mospërputhjet në informacion. Kur mospërputhjet detektohen, gazetari duhet të kërkoj t'i qartësoj ato para se t'i përdor shifrat si "fakte" apo "njohurinë e përgjithshme" në një reportazh.

Gazetarët/et duhet po ashtu të shmangen nga raportimi i të gjeturave hulumtuese pa i shqyrtuar faktorët që mund t'i kenë ndikuar rezultatet. Gazetarët/et duhet ta përvetësojnë një skepticizëm të përgjithshëm për hulumtime që përkthehen në pyetjet rreth burimit të hulumtimit dhe qëllimit të tij. Gazetari/ja duhet t'i bëjë pyetjet në vijim: A ka qenë i sponsorizuar hulumtimi? Nga kush apo nga cila organizatë? Cila metodologji e hulumtimit është përdorur? A lidhen të gjeturat me statistikat?

# AGJENDA E PUNËTORISË

# AGJENDA E PUNËTORISË - PUNËTORI NJË-DITORE

Kohëzgjatja e punëtorisë: 8 orë

## TRAJNIM PËR MEDIA RRETH NDJESHMËRISË GJINORE

10.00-11.00

### SESIONI 1: HYRJE

*Hapja*

*Prezantimet*

*Pritshmëritë e Pjesëmarrësve/eve dhe Objektivat e Punëtorisë*

*Shqyrtim i Orarit të Punëtorisë*

11.00 - 12.00

### SESIONI 3: TË KUPTUARIT E GJINISË

*A. Kujtime të Hershme rreth të qenit Mashkull apo Femër*

12.00 – 12.20

### PUSHIM PËR KAFE

12.20 – 13.40

### SESIONI 3: TË KUPTUARIT E GJINISË

*B. Pritshmëritë për Rolet Gjinore dhe Stereotipet*

*C. Të përkufizuarit e gjinisë*

*D. Ndikimi institucional/Sistemor në Stereotipet Gjinore*

13.40 – 14.20

### SESIONI 5: TË PËRKUFIZUARIT E DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE

*A. Përkufizimi i Dhunës në Bazë Gjinore dhe Dhunës ndaj Grave*

14.20 – 15.00

### DREKA

15.00 - 16.00

### SESIONI 5: TË PËRKUFIZUARIT E DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE

*B. Format dhe Intensiteti i Dhunës në bazë Gjinore dhe Dhunës ndaj Grave*

16.00 - 16.30

### SESIONI 6: RAPORTIMI GJINOR NË MEDIA DHE RAPORTIMI PËR DHUNËN NDAJ GRAVE

*A. Të Metat e Medieve në Raportim për Gratë*

16.30 – 16.50

### PUSHIM PËR KAFE

16.50 – 17.35

### SESIONI 6: RAPORTIMI GJINOR NË MEDIA DHE RAPORTIMI PËR DHUNËN NDAJ GRAVE

*B. Të metat në raportim për dhunën ndaj grave*

17.35 – 18.00

### PËRMBYLLJA

*Përfundimi, Pyetje&Përgjigje dhe Vlerësimi*

## AGJENDJA E PUNËTORISË – PUNËTORI TRE DITORE

Kohëzgjatja e punëtorisë: 4 orë në ditë (punëtori gjysmë ditore)

### TRAJNIM PËR MEDIA RRETH NDJESHMËRISË GJINORE – DITA 1

10.00-11.00

#### SESIONI 1: HYRJE

*Hapja*

*Prezantimet*

*Pritshmëritë e Pjesëmarrësve/eve dhe Objektivat e Punëtorisë*

*Shqyrtim i Orarit të Punëtorisë*

11.00 - 12.00

#### SESIONI 3: TË KUPTUARIT E GJINISË

*A. Kujtime të Hershme rreth të qenit Mashkull apo Femër*

12.00 - 12.30

#### PUSHIM PËR KAFE

12.30 – 13.50

#### SESIONI 3: TË KUPTUARIT E GJINISË

*B. Pritshmëritë për Rolet Gjinore dhe Stereotipet*

*C. Ta përkufizojmë gjininë*

*D. Ndikimi institucional/Sistemor në Stereotipet Gjinore*

13.50 – 14.00

#### PËRMBYLLJA

*Përfundimi, Pyetje&Përgjigje dhe Vlerësimi*

### TRAJNIM PËR MEDIA RRETH NDJESHMËRISË GJINORE – DITA 2

10.00-10.15

#### HYRJE

*Përmbledhje e shkurtër e pikave nga sesionet e kaluara*

*Përmbledhje e shkurtër e agjendës së kësaj dite*

10.10-12.00

#### SESIONI 2: KORNIZË E ANALIZËS GJINORE PËR MEDIA

*A: Përfaqësimi i Grave në Media*

*B: Roli i Medieve në Shoqëri*

*C. Të përkufizuarit e gjinisë*

12.00 - 12.30

#### PUSHIM PËR KAFE

12.30 – 13.50

#### SESIONI 5: TA PËRKUFUARIT E DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE

*A. Të përkufizuarit e Dhunës në Bazë Gjinore dhe Dhunës ndaj Grave*

*B. Format dhe Intensiteti i Dhunës në bazë Gjinore dhe Dhunës ndaj Grave*

13.50-14.00

#### PËRMBYLLJA

*Përfundimi, Pyetje&Përgjigje dhe Vlerësimi*

## AGJENDJA E PUNËTORISË – PUNËTORI TRE-DITORE

Kohëzgjatja e punëtorisë: 4 orë në ditë (punëtori gjysmë ditore)

### TRAJNIM PËR MEDIA RRETH NDJESHMËRISË GJINORE - DITA 3

10.00-11.00

#### HYRJE

*Përmbledhje e shkurtër e pikave të sesioneve të kaluara  
Përmbledhje e shkurtër e sesioneve të agjendës së sotme*

10.10-11.40

#### SESIONI 6: RAPORTIMI GJINOR NË MEDIA DHE RAPORTIMI PËR DHUNËN NË BAZË GJINORE

*A. Të Metat E Medieve në Raportim për Gratë  
B. Të metat në raportim për dhunën ndaj grave*

11.40 – 12.10

#### PUSHIM PËR KAFE

16.50 – 17.35

#### SESIONI 7: NJOHURI DHE SHKATHTËSI TË PËRMIRËSUARA & ETIKA PËR NDJESHMËRI GJINORE NË MEDIA

*A. Ligjet Lokale që Adresojnë Dhunën në bazë Gjinore  
B. Etika për Ndjeshmëri Gjinore në Media*

13.40 – 14.00

#### PËRMBYLLJA

*Mësimet e nxjerra, Pyetje&Përgjigje dhe Vlerësimi*



## AGJENDA E PUNËTORISË –PUNËTORI PESË DITORE

Kohëzgjatja e punëtorisë: 4 orë

### TRAJNIM PËR MEDIA RRETH NDJESHMËRISË GJINORE – DITA 1

10.00-11.00

#### SESIONI 1: HYRJE

*Hapja*

*Prezantimet*

*Pritshmëritë e Pjesëmarrësve dhe Objektivat e Punëtorisë*

*Shqyrtim i Orarit të Punëtorisë*

11.00 - 12.10

#### SESIONI 2: KORNIZË E ANALIZËS GJINORE PËR MEDIA

*A: Përfaqësimi i Grave në Media*

*B: Roli i Medieve në Shoqëri*

12.10 – 12.40

#### PUSHIM PËR KAFE

12.40 – 13.40

#### SESIONI 2: KORNIZË E ANALIZËS GJINORE PËR MEDIA

*C. Të përkufizuarit e gjinisë*

13.40 – 14.00

#### PËRMBYLLJA

*Përfundimi, Pyetje&Përgjigje dhe Vlerësimi*

### TRAJNIM PËR MEDIA RRETH NDJESHMËRISË GJINORE - DITA 2

10.00-10.15

#### HYRJE

*Përmbledhje e shkurtër e pikave të sesioneve të kaluara*

*Përmbledhje e shkurtër e sesioneve të agjendës së sotme*

10.15-12.00

#### SESIONI 3: TË KUPTUARIT E GJINISË

*A. Kujtime të Hershme rreth të qenit Mashkull apo Femër*

*B. Pritshmëritë për Rolet Gjinore dhe Stereotipet*

12.00 - 12.30

#### PUSHIM PËR KAFE

12.30 – 13.30

#### SESIONI 3: TË KUPTUARIT E GJINISË

*C. Të përkufizuarit e gjinisë*

*D. Ndikimi Institucional/Sistemor për Stereotipet Gjinore*

13.30-13.45

#### PËRMBYLLJA

*Përfundimi, Pyetje&Përgjigje dhe Vlerësimi*

## AGJENDA E PUNËTORISË –PUNËTORI PESË DITORE

Kohëzgjatja e punëtorisë: 4 orë

### TRAJNIM PËR MEDIA RRETH NDJESHMËRISË GJINORE - DITA 3

10.00-10.15

#### HYRJE

*Përmbledhje e shkurtër e pikave të sesioneve të kaluara  
Përmbledhje e shkurtër e sesioneve të agjendës së sotme*

10.15 - 12.30

#### SESIONI 4: PERCEPTIMET DHE PRITSHMËRITË GJINORE

*A. Perceptimet per Gratë dhe Burrat  
B. Baza Kulturore e Stereotipeve Gjinore  
C. Strategjitë për të Sfiduar dhe Eliminuar Stereotipet dhe Barrierat Gjinore  
D. Ushtrim për të Siguruar se Përkufizimet për Stereotipet në Bazë të Seksit dhe Gjinisë Kuptohen*

12.30 – 13.00

#### PUSHIM PËR KAFE

13.00 – 13.45

#### SESIONI 5: TA PËRKUFIZUARIT E DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE

*A. Përkufizimi i Dhunës në Bazë Gjinore dhe Dhunës ndaj Grave*

13.45 – 14.00

#### PËRMBYLLJA

*Përfundimi, Pyetje&Përgjigje dhe Vlerësimi*

## AGJENDA E PUNËTORISË –PUNËTORI PESË-DITORE

Kohëzgjatja e punëtorisë: 4 orë

### TRAJNIM PËR MEDIA RRETH NDJESHMËRISË GJINORE - DITA 4

10.00-10.15

#### HYRJJE

*Përmbledhje e shkurtër e pikave të sesioneve të kaluara  
Përmbledhje e shkurtër e sesioneve të agjendës së sotme*

10.15 - 11.15

#### SESSIONI 5: PËRKUFIZIMI I DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ GRAVE

*B. Format dhe Intensiteti i Dhunës në bazë Gjinore dhe Dhunës ndaj Grave*

11.15 - 12.00

#### SESSIONI 6: RAPORTIMI GJINOR NË MEDIA DHE RAPORTIMI PËR DHUNËN NDAJ GRAVE

*A. Të Metat E Medieve në Raportim për Gratë*

12.00 - 12.30

#### PUSHIM PËR KAFE

12.30 - 13.30

#### SESSIONI 6: RAPORTIMI GJINOR NË MEDIA DHE RAPORTIMI PËR DHUNËN NË BAZË GJINORE

*B. Të Metat në Raportim për Dhunën ndaj Grave*

13.30 - 13.45

#### PËRMBYLLJA

*Përfundimi, Pyetje&Përgjigje dhe Vlerësimi*

## AGJENDA E PUNËTORISË –PUNËTORI PESË-DITORE

Kohëzgjatja e punëtorisë: 4 orë

### TRAJNIM PËR MEDIA RRETH NDJESHMËRISË GJINORE - DITA 5

10.00-10.15

#### HYRJE

*Përmbledhje e shkurtër e pikave të sesioneve të kaluara  
Përmbledhje e shkurtër e sesioneve të agjendës së sotme*

10.15 - 11.45

#### SESIONI 7: NJOHURI DHE SHKATHTËSI TË PËRMIRËSUARA & ETIKA E NDJESHME GJINORE NË MEDIA

*A. Ligjet Lokale që Adresojnë Dhunën në bazë Gjinore  
B. Etika e Ndjeshme Gjinore në Media*

11.45 – 12.15

PUSHIM PËR KAFE

12.15 – 13.45

#### PËRMBYLLJA

*Mësimet e nxjerra  
Pyetje dhe përgjigje  
Përmbledhja  
Vlerësimi*



## **CARE INTERNATIONAL BALKAN:**

- Petra Lekovica 59
- 11000 Belgrade, Serbia
- Phone: +381 11 3558 802
- Email: mstarcevic@care.rs

- Hasana Kaimije 11
- 71000 Sarajevo
- Bosnia and Herzegovina
- Phone: +387 33 536 790

- Aleja Svetog Save 7a #17
- 78000 Banja Luka
- Bosnia and Herzegovina
- Phone: +387 51 258 200
- Email: spetkovic@carewb.org,
- jcrowover@carewb.org

- Gazmend Zajmi # 21
- 10 000 Prishtinë, Kosovë
- tel: +381 (0) 38 224 779; 222 435
- Email: Besnik.Leka@co.care.org


**[www.youngmeninitiative.net](http://www.youngmeninitiative.net)**





PËRKRAHUR NGA

WITH FUNDING FROM  
 AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

 OAK  
FOUNDATION

ORGANIZATAT IMPLEMENTUESE TË YMI:



STATUS 



 O.E.K.  
СИНЕРГИЈА



smart  
KOLEKTIV